



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Menaxhim
Biznesi”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.As. Arlinda Ymeraj
2. Prof.As. Ermelinda Kordha

Tetor/2023

RAPORTI I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofruar nga Institucioni i
Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Barleti
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave (Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Menaxhim Biznesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Licensuar me VKM Nr. 571, datë 12.08.2005
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS nr. 309, datë 27.07.2012 , Riorganizimi i Brendshëm i Njësive Kryesore të SHLUJP "Universiteti "Marin Barleti", organizohet: Fakulteti i Ekonomisë dhe Financës (3 Njësi Bazë), Fakulteti i Drejtësisë (3 Njësi Bazë), Fakulteti i Shkencave Sociale (3 Njësi Bazë), Fakulteti i Shkencave të Aplikuara (5 Njësi Bazë)/ VKA Nr. 35, datë 05.05.2015 & Urdhër 202, datë 25.05.2015 Riorganizimin e njësive kryesore të SHLUJP "Universiteti Marin Barleti"/SHLUJP "Universiteti "Marin Barleti", organizohet: Fakulteti i Drejtësisë dhe shkencave Politike (5 njësi bazë), Fakulteti i Shkencës dhe Ekonomisë (4 njësi bazë)/ UMASR nr 213 datë 03.07.2020 SHLUJP "Universiteti "Marin Barleti" riorganizohet në Universitetin "Barleti" me tre Fakultete: Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave të aplikuara dhe Industrive Kreative, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 91, datë 23.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMAS nr.288, datë 04.09.2009/ VKA Nr. 32, datë 28.07.2009
8	Cikli i studimit:	Bachelor
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	N/A
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A




15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6-1
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14 PAE/ 20 PAK (Sipas të dhënave të aneks tabelës 1, viti akademik 2021-2022, për Departamentin e Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës)
18	Numri i studentëve:	39 (Sipas të dhënave të tabelës nr. 23- për diplomimin dhe punësimin e studentëve, periudha e të dhënave 2019-20 & 2021-22)
19	Komente / të tjera:	N/A

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave, Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, në Universitetin “Barleti”.

Institucioni i Arsimit të Lartë, jo publik, Universiteti “Barleti” është hapur me UMASH nr. 2365 datë 12.04.2006, në mbështetje të nenit 13 të ligjit numër 8461 datë 25.09.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 571, datë 12.08.2005 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike, universiteti “Marin Barleti” si dhe të VKM nr.156 datë 22.03.2001 “Për shkollat e larta jo publike në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij urdhëri të MASH, programi i studimit Menaxhim Biznesi ofrohej nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, tituli i lëshuar i diplomës për këtë program studimi “Menaxher Biznesi”, ofruar me një sistem studimi me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, me kohëzgjatje 3 vite akademike.

Universiteti “Barleti” ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit të zhvilluar nga ASCAL. Sipas UMAS Nr. 288, datë 04.09.2009 institucioni ka marrë akreditimin pozitiv të institucionit si dhe akreditimin pozitiv të programit të studimit “Menaxhim Biznesi” me kohëzgjatje normale 3 vite dhe me 180 kredite. Afati i akreditimit për 6 vite. Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit numër 09 datë 07.04.2017 IAL ka marrë gjithashtu vlerësim pozitiv lidhur me akreditimin institucional periodik të tij me një kohëzgjatje prej 6 vite akademike. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të IAL është 06/04/2023. Pas aktit zyrtar të riorganizimit UMASR nr.213 datë 03.07.2020 si dhe bazuar në VBA e akreditimit të mëparshëm, Bordi i akreditimit nëpërmjet vendimit nr. 60 datë 16.12.2021 ka dhënë vlerësim pozitiv për IAL Universiteti Barleti, me kohëzgjatje 5 vite dhe me një afat vlefshmërie deri më 15.12.2026. Aktet rregullatore të IAL-së, Statuti e Rregulloret e Institucionit janë rishikuar në përputhje me ligjin për arsimin e Lartë dhe aktet normative në fuqi, siç janë konstatuar dhe nga GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave në IAL. Institucioni ka përgatitur një Plan Strategjik i cili është i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të programit të studimit si dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve që diplomohen.

Universiteti “Barleti” përbëhet nga 3 njësi kryesore/Fakultete: Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë i cili përbëhet nga 3 njësi bazë/Departamente:

- Departamenti i Drejtësisë
- Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave
- Departamenti i Qeverisjes, Shkenca Politike dhe Komunikim

Sipas Vendimit të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë nr. 198 datë 17.10.2016 dhe sipas urdhërit të MAS nr. 554 datë 23.11.2016 dhe është realizuar akreditimi periodik i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë të SHLUIJ “Universiteti Marin Barleti”, me 180 kredite, me formë studimi me kohë të plotë dhe të pjesshme, me kohëzgjatje 3 vite/ 6 semestra në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare Bachelor në Menaxhim Biznesi. Ky program studimi është hartuar në konsideratë të zhvillimeve social-ekonomike të vendit tonë si dhe një analize të tregut të punës.

Siç paraqitet në dokumentat orientuese të IAL-së, programi synon t’u ofrojë studentëve njohuri të thelluara në ekonomi dhe menaxhim, me synim përgatitjen e vendimmarrësve, menaxherëve dhe

studiuesve të ekonomisë. Programi i ciklit të parë, Bachelor në “Menaxhim Biznesi” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve dhe specialitetesh si menaxher financiar, ekonomist, analist tregu, analist biznesi, etj., duke plotësuar nevojat të konsiderueshme të tregut dhe institucioneve publike e jo publike, në vijim të realizimit të objektivave e prioriteteve strategjike të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

GVJ kërkoj dhe aksesoi gjatë vizitës të dhënat lidhur me përbërjen e stafit, titujt akademikë dhe ngarkesën e personelit akademik. GVJ vlerëson se personeli akademik, ndihmës mësimor–shkencor dhe administrativ angazhohet për përmbushjen e objektivave të programit të studimit dhe të zhvillimit të institucionit.

Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë mat ecurinë e programit të studimit për qëllime përmirësimi duke përdorur një metodologji me instrumente matëse dhe vlerësuese si pyetësorët për studentët, raporte të njësive kryesore e njësive bazë, vlerësime për pedagogët nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave, por edhe Fakulteti.

Institucioni realizon vlerësim të programit të studimit nëpërmjet pyetësorit të studentëve, intervistave, fokus grupeve dhe ekipeve të vlerësimit. Vlerësimi zhvillohet gjithashtu nga drejtuesi i njësisë bazë, por edhe në nivel Fakulteti nëpërmjet shkëmbimit interaktiv me stafin dhe vlerësimeve në fund të vitit bazuar në veprimtarinë shkencore të personelit akademik, të cilat rezultojnë të dokumentuara në departamentin e Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave si njësi përgjegjëse e programit.

Institucioni vë në dispozicion të studentëve platformën e bibliotekës online, një bibliotekë e pasur me literaturë bashkëkohore, gjithashtu edhe pjesë e rrjeteve dixhitale duke lehtësuar aksesin e studentëve. Sidoqoftë, kufizimet në njohjen e thelluar të gjuhëve të huaja, vështirësojnë aksesin e studentëve dhe ulin efektivitetin e shërbimit.

Pranimi i studentëve në këtë program studimi është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe Statutit të Universitetit, Rregullores së Fakultetit, Departamentit dhe të Programit.

Institucioni mban të dhëna dhe kontakte me studentët e këtij programi përmes sistemit të komunikimit të brendshëm, ku çdo student ka hapësirë vetjake të dedikuar përmes të cilit informohet e ka akses në dokumentacionin elektronik. GVJ konstatoi se përmes zyrës së Alumnit dhe Karrierës institucioni mban kontakte me studentët dhe pas përfundimit të studimeve.

Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe vendase e të huaja me qëllim kualifikimin e mëtejshëm të stafit, tërheqjen e studentëve të huaj, ndërtimin e programeve të reja të studimit dhe ndërkombëtarizimin.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ka ndjekur hapat rigoroze të cilat janë në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Procesi nisi me kontaktin me ekspertët, të cilët u trajnuan për standardet e cilësisë dhe kriteret, si edhe mbi përdorimin e sistemit elektronik, në seksionin paneli i ekspertit. Në këtë faze të parë u vendos një komunikim i mirë i grupit të punës, i përbërë nga ekspertët dhe koordinatori Teknik i ASCAL.

Pas njohjes dhe vlerësimit të dosjes së vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, u hartua axhenda e vizitës në institucion. Në fazën e dytë, u zbatua me rigozitet axhenda e takimeve në 29.03.2023, gjatë vizitës në institucion.


GVJ mblodhi informacionin e nevojshëm për një vlerësim rigoroz bazuar në takime me Përgjegjës të Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës, Sekretarinë mësimore, Burimet Njerëzore dhe Studentët e programit të studimit. Të gjitha informacionet e mblodhura nga takimet, u përdorën nga grupi i vlerësimit të jashtëm, i përbërë nga Prof As. Arlinda Ymeraj dhe Prof As. Ermelinda Kordha për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm.

Gjatë të gjithë procesit GVJ u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, Znj. Endra Velaj dhe Znj. Denisa Bogdani.

Më datë 08/09/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 13/75 Prot., datë 08/09/2023, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti “Barleti” kthehu përgjigje me shkresë zyrtare Nr. 972 Prot., datë 15/09/2023.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 198, date 17.10.2016 janë:

1. Të pasurohet më tej fondi i librave dhe titujve të rinj në fushën e menaxhimit të biznesit.
2. Të përmirësohet më tej raporti midis stafit akademik me grada dhe tituj shkencorë që mbulon këtë program studimi.
3. Të ulet ngarkesa mësimore aktualisht e lartë e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.
4. Të shtohet numri i personelit administrativ në nivel departamenti.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Të pasurohet më tej fondi i librave dhe titujve të rinj në fushën e menaxhimit të biznesit.

Duke u bazuar në situatën e shqyrtuar direkt në institucion, si dhe evidencat dokumentare mund të themi se institucioni ka bërë përpjekje të mira për të përmbushur këtë rekomandim, duke shtuar titujt e librave në bibliotekën e institucionit. Gjithashtu ka një procedurë të përcaktuar për shtimin e titujve në bibliotekë. Institucioni, duke përfshirë pedagogët dhe studentët përfiton nga biblioteka digjitale, ku aksesi në disa baza të dhënash digjitale për libra dhe artikuj, ka përmirësuar fondin e bibliotekës dhe punën me literaturën.

Evidenca 30 Listë e teksteve në bibliotekë



Evidenca 30.b Kërkesë për tituj librash DSEF

Evidenca 30.d TË dhëna për infrastrukturën e bibliotekës në funksion të programeve të studimit DSEF

2. Të përmirësohet më tej raporti midis stafit akademik me grada dhe tituj shkencorë që mbulon këtë program studimi.

UniBa I ka kushtuar rëndësi përfshirjes së stafit të duhur akademik në këtë program studimi, ku ka rritur përfshirjen e stafit akademik me tituj dhe grada. Gjithashtu Ne vitin e fundit është përmirësuar raporti midis stafit akademik të brendshëm dhe atij të jashtëm në këtë program studimi. Stafi akademik me tituj dhe grada përbën 61.1% të të gjithë stafit të programit të studimit.

Evidenca 24 Personeli akademik ,tabela 6.1



3. Të ulët ngarkesa mësimore aktualisht e lartë e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.

Universiteti Barleti ka bërë përpjekjet e duhura për të ulur ngarkesën mësimore të personelit akademik, duke përmbushur kuadrin ligjor në fuqi në lidhje me këtë komponent të punës akademike. Ngarkesa është ulur duke ulur dhe numrin e lëndëve për secilin lektor, duke u dhënë kështu mundësi pedagogëve të realizojnë edhe më shumë punë kërkimore-shkencore.

Evidenca 24 Personeli akademik ,tabela 6.1

Evidenca 25 Të dhëna tabelare për ngarkesën akademike, tabela 4

4. Të shtohet numri i personelit administrativ në nivel departamenti.

Duke u bazuar në raportimin e vetë institucionit stafi administrativ është i organizuar në nivel Universiteti dhe në këtë drejtim nuk janë bërë ndryshime në strukturën administrative të institucionit, duke gjykuar se ka një efektivitet më të lartë dhe duke vendosur disa detyra administrative tek pozicioni i koordinatorit të departamentit.

Evidenca 47: Urdhër i brendshëm nr 29, dt. 14.10.2022, për emërimin e koordinatorit të departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës.

Evidenca 1.2 Rregullore e UniBa


Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Menaxhim Biznesi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE


Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" i ofruar nga departamenti i Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, në Fakultetin e Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, në Universitetin Barleti, është në përputhje me Misionin dhe Qëllimet e Institucionit të shprehura tek Strategjia e Zhvillimit Institucional UniBa 2020-2030, miratuar me vendimin numër 111 prot. të Bordit të Administrimit datë 16.02.2021, Pika III.1 dhe III.2. Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimeve ekonomike e sociale të vendit. UniBa synon të përgatisë studentë të një niveli të lartë, profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës, të aftë për sfidat e të tashmes dhe të së ardhmes, si dhe qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm. UniBa synon gjithashtu të zhvillojë kërkim shkencor aplikativ në koordinim të vazhdueshëm me qendrat dhe institutet e UniBa dhe me nevojat e operatorëve zbatues në ekonomi, shoqëri dhe sipërmarrje. Ky program u paraprin sfidave të politikave të zhvillimit ekonomik në vendin tonë në mbështetje të interesave kombëtare si edhe të prioriteteve të zhvillimit, siç edhe përcaktohen tek shtylla II-Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër dhe shtylla III- Kohëzoni social të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030.</p> <p>Gjithashtu zbatimi i politikave efektive të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm ka nevojë për specialistë të kualifikuar, të aftë që të plotësojnë kërkesat në rritje të ekonomisë dhe sipërmarrjes në vend. Kësaj prirje i përgjigjet UniBa me programin e studimit Bsc në “Menaxhim Biznesi” i cili mbështet zhvillimin e aftësive të specializuara të studentëve që në ciklin e parë të studimit. Programet e studimit të ciklit të parë Bachelor ofrohen në përputhje me misionin dhe vizionin e UniBa, të përcaktuara tek strategjia për zhvillimin e UniBa, tek e cila nënvizohet: “krijimi i një institucioni të arsimit të lartë cilësor, i cili ofron vlera të vërteta profesionalizmi dhe qytetarie, duke bashkuar edukimin me shpirtin e sipërmarrjes dhe e realizon atë me anë të kombinimit të natyrshëm të shërbimeve online me ato të drejtpërdrejta në mjediset e tij. Në kuadër të vizionit të tij UniBa synon të bëhet një institucion inovativ dhe lider, digjital, aplikativ dhe praktik, ndërveprues dhe komunitar, i orientuar nga tregu i punës, duke</p>

	<p>vendosur studentin në qendër dhe duke zhvilluar bashkëpunime rajonale dhe ndërkombëtare”.</p> <p>Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit Bsc. në Menaxhim Biznesi gjithashtu tek misioni i saj thekson se UniBa është një organizatë e përkushtuar për të mbështetur arritjet intelektuale, zhvillimin e fuqisë punëtore, angazhimin qytetar si dhe promovimin e vlerave individuale, parimet e tregut të lirë dhe barazinë mes njerëzve.</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga UniBa, janë një pjesë e rëndësishme me vlerë strategjike për ekonominë e vendit dhe zhvillimin e tij afatgjatë. Zhvillimi ekonomik i vendit nuk mund të arrihet pa zhvillimin e biznesit dhe sipërmarrjes. Në këtë kontekst, ndërtimi i programit Bsc në “Menaxhim Biznesi”, garanton qëndrueshmëri, e cila konstatohet dukshëm përgjatë analizës së treguesve, e përforcuar edhe nga gjykimet e stafit akademik.</p> <p>GVJ gjykon se UniBa nëpërmjet programeve të tij, veçanërisht BSC në “Menaxhim Biznesi”, objekt i vlerësimit, përçon vlerat akademike dhe kulturore të vendit, në përputhje të plotë jo vetëm me karakteristikat e modelit të tranzicionit nga ekonomia e centralizuar në ekonomi tregu, por çka është më thelbësorja me burimet natyrore e njerëzore si edhe mundësitë e sipërmarrjes, për një përdorim efektiv të tyre, me qëllim rritjen ekonomike dhe zhvillimin social të vendit.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.1. Statuti i UniBa, pdf; Evidenca 5.Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf; Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional UniBa.pdf; Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>UniBa i udhëhequr nga misioni i përgatitjes së studentëve si profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës, të aftë për sfidat e të tashmes dhe të së ardhmes, si dhe qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm, ka hartuar dhe realizon programe, të cilat garantojnë përvetësimin e dijeve dhe njohurive shumëdimensionale, në drejtimet që vijojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Formimin menaxherial në drejtim të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. ▪ Mbështetjen e rrugëve inovative për të përmirësuar të mësuarit gjatë gjithë jetës si përmes traditës ashtu dhe përmes teknologjive të reja. ▪ Krijimin e profesionistëve për institucionet financiare, agjensitë qeveritare dhe organizatat e biznesit. <p>GVJ vlerëson se programi i studimit Bsc në “Menaxhim Biznesi” në ciklin e parë të studimeve, si pjesë e Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave, hartohet dhe ofrohet në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë së institucionit si edhe me qëllimin dhe misionin e tij.</p>

	<p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion;Evidenca 1.1. Statuti i UniBa, pdf; Evidenca 5.Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf; Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional UniBa.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Menaxhim Biznesi” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave. Rregullorja e departamentit si edhe rregullorja e programit “Menaxhim Biznesi” përcaktojnë qartë objektivat e programit Menaxhim Biznesi, si një program që synon përgatitjen e vendimmarrësve, menaxherëve dhe studjuesve të ekonomisë me drejtim zhvillimin ekonomik. Gjithashtu si një program që ofron njohuri teorike dhe praktike në fushën e menaxhimit si dhe problemet dhe sfidat që lidhen me funksionimin e një organizate.</p> <p>GVJ gjykon që ky program përputhet plotësisht me Strategjinë e Zhvillimit Institucional, e cila i kushton vëmendje të veçantë gjetjes së mënyrave novatore për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe ofrimin e njohurive dhe dijeve bashkëkohore, për të realizuar objektivat e institucionit, dhe përtej tyre kontribuar në realizimin e objektivave të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.</p> <p>Statuti i Institucionit, Rregullorja e Departamentit dhe Rregullorja e programit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike, në të cilat saktësohet Njësia bazë si një qendër bashkëkohore studimi, kërkimi dhe transferimi të njohurive, për t’u bërë pjesë integrale e një bote, ku studentët e diplomuar në Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë të gjejnë veten e tyre dhe të kontribuojnë me dije e profesionalizëm në menaxhimin e organizatave, financave, kontabilitetit, marketingut, ekonomisë dhe politikave ekonomike etj., në kuadër të integritimit Evropian të vendit.</p> <p>Program i studimeve të nivelit të parë, Bsc në “Menaxhim Biznesi” është pjesë e shtyllës së tretë dhe të pestë prioritare të listuar në Strategjinë e re 2020-2030 të institucionit, respektivisht të cilësuar si: Shtylla e Kërkimit të Aplikuar dhe Inovacionit dhe Shtylla Sipërmarrëse.</p> <p>GVJ konstaton se struktura dhe përmbajtja e programit të studimit përputhet plotësisht me drejtimet themelore akademike të institucionit. Siç nënvizohet edhe tek Rregullorja e Departamentit (neni 14), të gjitha programet e studimit janë bashkëkohore, plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe europiane, si edhe të harmonizuara në fusha që plotësojnë njëra-tjetrën. Programet janë të organizuara dhe mundësojnë ndjekjen dhe përfundimin e të gjitha cikleve të studimit.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1. Rregulloret e Fakultetit.pdf; Evidenca 1.1. Statuti i UniBa, pdf; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf; Evidenca 1.3.Rregullore e Departamentit Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave.pdf; Evidenca</p>




	<p>5.Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf; Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional UniBa.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi Bsc në “Menaxhim Biznesi” ofrohet Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave, një nga 3 departamentet e Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, që nga viti 2006 në zbatim të Urdhërit Nr.2365 prot. date 12.04.2006, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Njësia bazë ka përvojë të mjaftueshme dhe cilësore për të ofruar këtë program, përvojë që rrjedh sa nga e kaluara dhe tradita e institucionit, aq edhe nga niveli profesional dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në mësimdhënie dhe bashkëpunimet me institucione të tjera të njohura jashtë vendit.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në Programin Bsc në “Menaxhim Biznesi” përbëhet nga 26 pedagogë, nga të cilët 50% janë me kohë të pjesshme. 3 pedagogë të brendshëm dhe një pedagog i jashtëm ose 15,4% e stafit mbajnë titujt Prof.Dr dhe Prof.Asoc.Dr. 9 pedagogë, përkatësisht 5 të brendshëm dhe 5 me kohë të pjesshme mbajnë titullin Msc. 50% e stafit të përgjithshëm mban gradën shkencore Doktor. (Lista e plotë e personelit të programit).</p> <p>GVJ gjykon që njësia bazë ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të siguruar cilësinë më të lartë në mësimdhënie bazuar tek trajnimet profesionale të stafit, procedurat e rekrutimit dhe seleksionimit që IAL ndjek marrjen e stafit të ri, raportimin e punës kërkimore shkencore si dhe analizën vjetore të departamentit mbi arrijtjen e objektivave të programeve të studimit.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1. Rregulloret e Fakultetit.pdf; Evidenca 7. Manual i menaxhimit të burimeve njerëzore.pdf; Evidenca 21. Relacion për kërkimin shkencor.pdf; Evidenca 22.1. Tabela përmbledhëse për trajnimet profesionale.pdf; Evidenca 23.1. Të dhëna tabelore për lëndët me ngarkesën tab.12,7,8,.pdf; Evidenca 24. Personeli akademik ,tabela 6.1.pdf; Evidenca 46. Raport Vjetor i kërkimit shkencor për vitin akademik 2021-2022.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bsc në “Menaxhim Biznesi” përputhet me fushat akademike kërkimore të njësisë kryesore. Struktura e programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi është e organizuar sipas veprimtarive formuese të përcaktuara në VKM nr. 41 datë 24.01.2018 dhe ndryshimeve të përcaktuara për të (VKM nr.185 datë 25.03.2021). Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit në proces akreditimi është Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave, ndërsa njësia kryesore Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë. GVJ gjykon se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për programin e studimit. Në dokumentin</p>




	<p>Strategjia e Zhvillimit Institucional (evidenca 10), në pikën III.2.1. specifikohen shtyllat kryesore mbi të cilat IAL do të mbështesë aktivitetin e tij në përmbushje të misionit dhe vizionit për programet e ofruara të studimit sipas strategjisë së planifikuar për periudhën 2020-2030. Lidhur me programin e studimit Bsc në Menaxhim Biznesi GVJ gjykon se dy janë shtyllat të cilat lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me fushat kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë: Shtylla e kërkimit të aplikuar dhe inovacionit, dhe Shtylla Sipërmarrëse. Gjithashtu në faqen Web të IAL ku specifikohen fushat e kërkimit dhe inovacionit të institucionit sipas programeve evidentohen: <i>Programi I-Konkurueshmëria dhe Sipërmarrja</i> (me drejtime konceptuale kryesore: Bizneset konkurruese, Startup-në nivele të ndryshme: rajonal/kombëtar/qyteti/ekosistemi apo operatorësh; Inovacion shumë dimensional; Ekonomi e bazuar në dije; E ardhmja dixhitale); <i>Programi II: Industritë kreative, turizmi dhe sektorët e ndërlidhur</i>; <i>Programi III: Novacioni dhe e ardhmja dixhitale</i>; <i>Programi IV: Qytetet “e zgjuar” dhe rritja urbane</i>; dhe <i>Programi VI: Kapitali njerëzor për rritjen e qendrueshme</i>.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik konfirmoi se njësia kryesore analizon në mënyrë të vazhdueshme punën kërkimore shkencore dhe rezultatet e saj. <i>GVJ do të sugjeronte përcaktimin e fushave kërkimore të njësisë bazë dhe asaj kryesore duke i përfshirë këto në dokumnetacionin rregullator si tek Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Fakultetit si dhe tek Rregullorja e Programit të studimit.</i></p> <p>Në lidhje me kodifikimin e programit të studimit IAL është në pritje të akteve nënligjore për zbatimin e VKM-së nr.310 datë 11.05.2022.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional UniBa.pdf; Evidenca 43.VKM 412,viti 2018;Evidenca 43.a.VKM 879,viti 2019;Evidenca 43.b.VKM 185,viti 2021.pdf; Evidenca 45. Vendimi 310, datë 11.05.2022.Kodifikimi.pdf; https://umb.edu.al/fushat-e-kërkimit-dhe-novacionit.html]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i programit dhe diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të UniBa u konstatua se programi Bsc në “Menaxhim Biznesi” përbën risi në ofertën akademike të fakultetit, të transformuar për t’ju përgjigjur nevojave të zhvillimit të vendit.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bsc në “Menaxhim Biznesi” përputhet me fushat akademike kërkimore të njësisë kryesore.</i></p> <p><i>GVJ do të sugjeronte përcaktimin e fushave kërkimore të njësisë bazë dhe asaj kryesore duke i përfshirë këto në dokumnetacionin rregullator si tek Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Fakultetit si dhe tek Rregullorja e Programit të studimit.</i></p>
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p> <p>Përmbushet kryesisht</p> <p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.

Nga vizita në Institucion, GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bsc në “Menaxhim Biznesi”, Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave si njësi bazë përgjegjëse koordinon punën për të përmbushur objektivat e programit dhe angazhuar staf të kualifikuar. Një pjesë e konsiderueshme e lëndëve bazë të programit mbulohen nga stafi i Departamentit (rreth 81.8%), ndërsa angazhohet staf nga departamentet e tjera të UniBa.

Programi i studimit BSc në “Menaxhim Biznesi” lejon bashkërendim të stafit në disa disiplina formimi, si ekonomiksi, financa dhe kontabiliteti, teknologjia e informacionit, statistika, sociologjia, drejtësia etj. I gjithë procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikëqyret nga instancat drejtuese të UniBa duke filluar nga Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, NJZHKSC etj.


Çdo vit akademik realizohet dhe një analizë e punës së njërive në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e UniBa.

[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1. Rregulloret e Fakultetit.pdf; Evidenca 1.1. Statuti i UniBa, pdf; Evidenca 5.Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf; Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional UniBa.pdf]

Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.

GVJ konstaton se institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi. Institucioni, ka ndërmjetësuar 30 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës (sipërmarrje, institucione publike, OJF) të cilët japin një kontribut tepër të vyer për lehtësimin e tranzicionit të studentëve nga studimi në tregun e punës, nëpërmjet realizimit të praktikave mësimore si dhe institucione të arsimit të lartë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Programit të Studimit tek çështja “Marrëdhëniet me Partnerët” (evidenca 5), Departamenti dhe të gjithë anëtarët e stafit mund të përfshihen në bashkëpunime nëpërmjet projekteve, nëse kualifikimi i tyre profesional përputhet me kërkesat e projektit. Ndonëse informimi dhe menaxhimi i përgjithshëm i projektit koordinohet nga zyra e Rektorit ose Dekanatit, departamentet mbajnë peshën kryesore në hartimin dhe zbatimin e projektit. Angazhimi i UniBa lidhur me këtë kriter përcaktohet në pikat 4 dhe 5 të nenit 7 “Qëllimi” i Statutit të IAL. Gjithashtu në dokumentin Strategjia e




	<p>Zhvillimit Institucional tek çështja III.2. Qëllimet dhe objektivat IAL specifikon se UniBa synon të angazhohet në marrëshje bashkëpunimi me ente publike e private për veprimtari të përbashkëta didaktike të praktikave mësimore, kërkimit dhe konsulencës ndaj të tretëve. Një tjetër dokumentacion rregullator që udhëheq veprimtarinë e institucionit në kuadër të këtij kriteri është edhe Strategjia e Ndërkombëtarizimit të Institucionit.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.1. Statuti i UniBa, pdf; Evidenca 2.3.UniBa Paketa e Praktikës.pdf; Evidenca 5.Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf; Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional UniBa.pdf; Evidenca 10.1.Strategjia e ndërkombëtarizimit e UniBa.pdf; Evidenca 22.Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit.pdf; Evidenca 32.Lista e Konf. dhe aktivitete për mobilitet stafi;Evidenca 32.a;Evidenca 32.b.]</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të arritura nga institucioni, njësia përgjegjëse për programin mundëson realizimin e praktikave të studentëve. GVJ konstaton se mbikqyrja e praktikës gjithashtu realizohet në mënyrë të institucionalizuar në sajë të dokumentacionit tip të parapërgatitur (paketa e praktikës) i cili plotësohet nga mbikqyrësi përgjatë realizimit të praktikës mësimore.</p> <p>Institucioni ka vendosur zgjatjen e praktikës mësimore në një semester, e cila mundësohet në sajë të marrëdhënieve të bashkëpunimit që ka vendosur institucioni.Takimi me studentët konfirmoi vlefshmërinë e praktikave mësimore, të cilat ju shërbejnë atyre për të fituar shprehitë e para të punës praktike si edhe njohjen me tregun e punës. GVJ vlerëson se në drejtim të praktikave mësimore, rrjeti i bashkëpunimeve të njësisë përgjegjëse për programin, përbën një avantazh.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.1. Statuti i UniBa, pdf; Evidenca 2.3.UniBa Paketa e Praktikës.pdf; Evidenca 5.Strategjia e zhvillimit te programit te studimit MB.pdf; Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional UniBa.pdf; Evidenca 22.Lista e marreveshjeve te partneritetit ne funksion te programit te studimit.pdf; Evidenca 22.4.Lista e praktikave te studenteve.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Megjithëse në nivel universiteti, analiza e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit është objekt diskutimi, njësia përgjegjëse për programin do të ishte e interesuar të analizonte përfitimet në fushën e saj të interesit. Megjithatë kjo analizë nuk mund të realizohet nga njësia përgjegjëse për programin, pasi institucioni menaxhohet kryesisht në mënyrë të centralizuar.</p> <p>Njësia përgjegjëse për programin raporton, por nuk analizon në mënyrë të pavarur sepse marrëveshjet janë në nivel institucioni. Sidoqoftë, njësia përgjegjëse është pjesë e analizës vjetore. Një formë e analizës së këtyre përfitimeve e realizuar nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave është pikërisht integrimi i çështjes së</p>

	<p>përcaktuar nga ky kriter në analizën vjetore të arritjes së objektivave formuese të programit, si dhe gjurmimi i të dhënave të punësimit të studentëve si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>GVJ konstaton gjithashtu se çështja e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit nuk analizohet si tematikë e veçuar, por në kuadrin e përgjithshëm të analizës vjetore. Në këto kushte GVJ do të sugjeronte hartimin e një dokumenti tip të analizës së përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në nivelin e njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p>[Referenca: Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; 22.3.Të dhëna për diplomim dhe punësim;36. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit.pdf]</p>								
Konkluzione	<p>GVJ konstaton gjithashtu se çështja e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit nuk analizohet si tematikë e veçuar, por në kuadrin e përgjithshëm të analizës vjetore. Në këto kushte GVJ do të sugjeronte hartimin e një dokumenti tip të analizës së përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në nivelin e njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.		
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit është hapur me UMASH nr. 2365 datë 12.04.2006, në mbështetje të nenit 13 të ligjit numër 8461 datë 25.09.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 571, date 12.08.2005 “Për dhënien e lejes për hapjen e SHLUJP “Marin Barleti” si dhe të VKM nr.156 datë 22.03.2001 “Për shkollat e larta jo publike në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij urdhëri të MASH, programi i studimit Menaxhim Biznesi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, tituli i lëshuar i diplomës për këtë program studimi</p>		

“Menaxher Biznesi”, ofruar me një sistem studimi me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, me kohëzgjatje 3 vite akademike.

Në bazë të UMAS nr.288, datë 04.09.2009 institucioni ka marrë akreditimin pozitiv si dhe akreditimin pozitiv të programit të studimit Menaxhim Biznesi me kohëzgjatje normale 3 vite dhe me 180 kredite. Afati i akreditimit për 6 vite. Sipas VKA nr. 198 datë 17.10.2016 dhe sipas urdhërit të MAS nr. 554 datë 23.11.2016 është realizuar akreditimi periodik i programit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë të SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”, me 180 kredite, me formë studimi me kohë të plotë dhe të pjesshme, me kohëzgjatje 3 vite/ 6 semestra në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare Bachelor në Menaxhim Biznesi.

Programi është i organizuar në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS), konkretisht si një sistem studimi me kohë të plotë, me 180 ECTS, me kohëzgjatje 3 vite akademike. Sipas planit mësimor ky program përbëhet nga Lëndë Bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (6 lëndë/module/36 ECTS/ 20%), Lëndë Karakterizuese- përgatitje për disiplinën shkencore (17 lëndë/module/96 ECTS/ 53%), Lëndë ndërdisiplinore ose/dhe integruese- ndërdisiplina, profile dhe lëndë me zgjedhje (4 lëndë/module /24 ECTS/ 13%), Lëndë Plotësuese- gjuhë të huaja, njohuri informatike dhe praktika profesionale (3 lëndë/module/18 ECTS/ 10%), si edhe Detyrimet Përmbyllëse-Provim Diplome/6 ECTS/3%). Plani mësimor është i organizuar në 6 semestra të shpërndarë në tre vite akademike, me lëndë e module të vlerësuara me kredite. Në plan pasqyrohen 22 lëndë me 31 module. (Neni 9- Plani Mesimor, Neni 13- Kreditet, Neni 15- Natyra e lendeve mesimore sipas Evidenca 3 Rregullore e programit te studimit).

Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e një provimi të përgjithshëm formimi ose të përgatitjes dhe mbrojtjes të një punimi diplome, në varësi të notës mesatare (Neni 16- Prova finale Evidenca 3 Rregullore e programit te studimit). Kreditet e çdo disipline mesimore dhe veprimtarie formuese përlloragiten duke mbajtur parasysht ngarkesën në orë mesimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mesimore punë e studentit, ku futen orë mesimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.

[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 3.Rregullore e programit te studimit MB.pdf; Evidenca 2.1.aTabela dhe plani mesimor MB; Evidenca 2.1.b.plani mësimor MB; Evidenca 42.Ligji për Arsimin e Larte 2015..pdf; Evidenca 43.VKM 412,viti 2018;Evidenca 43.a.VKM 879,viti 2019]

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillim njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

GVJ, pasi analizoi programin e studimit, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe pas diskutimeve me stafin akademik të institucionin, gjykon se programi që vlerësohet realizon formimin e shprehive të veçanta dhe aftësimin e profesionistëve të ardhshëm me qëllim që t'iu përgjigjet më mirë nevojave të tregut, mbështetur edhe në eksperiencën e institucionit. Njësia kryesore ofron programin e studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" si Diplomë e veçantë. Hapja e këtij program është udhëhequr nga analiza e nevojave të tregut kryesisht.

Programi në ciklin e parë, Bachelor synon:


- Të përgatisë menaxherë dhe specialist në kompani e organizata të ndryshme publike dhe private
- Të përgatisë specialistë në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Të përgatisë specialist nëmenaxhimin e operacioneve organizative
- Të përgatisë menaxherë cilësi
- Të përgatisë menaxherë projektsh
- Të pajisë specialistët me instrumentat, teknikat dhe metodat më bashkëkohore, përmes të cilave ofrohen zgjidhje për sfidat e sektorit publik dhe privat të ekonomisë.
- Të pajisë specialistët me njohuritë më bashkëkohore në fushën e kërkimit, me qëllim mundësimin e një kualifikimi më të avancuar shkencor për nivelet e tjera të studimit në financë dhe menaxhim.

Përcaktimi i rezultateve të të nxënimit në programet mësimore (syllabuset e lëndëve) të secilës lëndë, ndihmon vlerësimin e arritjeve të studentëve në drejtim të formimit të shprehive të veçanta. Në dokumentin strategjia e zhvillimit të programit të studimit rezultatet e të nxënimit të programit të studimit përfshijnë aftësi si: zotërimin e njohurive për ti implementuar ato në proceset e biznesit, diagnostikimin dhe zgjidhjen e problemeve që lidhen me funksionet bazë të menaxhimit, formulimin e problemeve të projektit dhe planifikimin dhe kontrollin e projekteve; njohuri si: të kuptuarit e proceseve dhe dukurive komplekse që ndodhin në organizata, zotërimin e njohurive teorike të shkencave të menaxhimit ekonomisë dhe disiplinave plotësuese; kompetenca sociale si: aftësia vendimarrëse, aftësia për të komunikuar dhe negociuar, kuptimi i parimeve bazë të etikës, aftësia për të formuluar gjykime për çështje të rëndësishme shoqërore dhe ideologjike etj. Këto rezultate të të nxënimit pasqyrohen gjithashtu sipas lëndëve të ofruara nga programi i studimit tek silabuset përkatëse të shprehura në terma të njohurive, aftësive dhe kompetencave që përfiton studenti. Në përpjekje për tu përshtatur dhe përditësuar me kërkesat dhe trendet e tregut të punës si dhe të fushës së studimit, departamenti si njësi bazë e programit të studimit përditëson në mënyrë periodike listën e librave në bibliotekë.

GVJ gjykon që programi garanton llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh, sepse njohuritë e ofruara janë të larmishme. GVJ konstaton se programi Bachelor në "Menaxhim Biznesi" ofron njohuri të përparuar në fushën e studimit, përfundim i cili mbështetet nga

	<p>pesha e lëndëve të disiplinave karakterizuese (53%) si edhe nga larmishmëria e tyre. Lëndët karakterizuese përfshijnë thuajse të gjitha fushat në të cilat aplikohet menaxhimi si: Menaxhim Financiar, Menaxhim i Burimeve Njerëzore, Menaxhim i Cilësisë, Menaxhim Projektesh, Menaxhim Strategjik dhe Politikë Biznesi, Sjellje Organizative, Menaxhim i Operacioneve.</p> <p>Të njëjtin këndvështrim kanë edhe studentët e regjistruar në këtë program. Lëndët e përfshira në këtë program, përbajta e tyre si edhe metoda e mësimdhënies sigurojnë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të Menaxhimit, e cila përforçohet nga pjesëmarrja në leksione e të ftuarve, si nga fusha akademike ashtu edhe nga organizatat publike dhe politikëbërëse e operatorët e biznesit.</p> <p>GVJ gjykon që njësia kryesore është e paisur me të gjitha instrumentat dhe kapacitetet e nevojshme që të realizojë programet e studimit të ciklit të parë, të tilla që zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushat akademike dhe profesionale të renditura më lart.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 2.1.a Tabela dhe plani mësimor MB; Evidenca 2.1.b. plani mësimor MB; Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf; Evidenca 2.6.1. Programet lëndore (Syllabuset).pdf; Evidenca 30. Lista e teksteve në Bibliotekë.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar mbi synimet dhe objektivat e programit të studimit, të paraqitura tek Plani mësimor 2021-2022, si edhe Rregullorja e Programit, lehtësisht konstatohet rëndësia dhe vëmëndja që i kushton departamenti formimit të duhur sipas lëndëve të kategorizuara sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Programin që po vlerësohet, është organizuar: 36 ECTS ose 20 %, lëndë bazë (kategoria A); 96 ECTS ose 53%, lëndë karakterizuese (kategoria B); 24 ECTS ose 13%; lëndë integruese, ndërdisiplinore dhe me zgjedhje (kategoria C), 18 ECTS ose 10%, lëndë plotësuese (kategoria D) dhe 6 ECTS ose 3%, detyrime përmbyllëse (kategoria E).</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit është organizuar në përputhje me specifikimet ligjore (Neni 9- Plani Mësimor, Neni 13- Kreditet, Neni 15- Natyra e lëndëve mësimore tek Evidenca 3 Rregullore e programit tëi studimit; Evidenca 2.1.a Tabela e planit mësimor i programit të studimit i ndarë sipas veprimtarive A-E, Evidenca 2.1.b Plani mësimor i programit të studimit). GVJ gjykon që program i studimit që vlerësohet, nëpërmjet veprimtarive formuese të tij, ndikon në arritjen e objektivave akademike të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 3.Rregullore e programit te studimit MB.pdf; Evidenca 2.1.aTabela dhe plani mësimor MB; Evidenca 2.1.b.plani mësimor MB; Evidenca 42.Ligji për Arsimin e Lartë 2015..pdf; Evidenca 43.VKM 412,viti 2018;Evidenca 43.a.VKM 879,viti 2019]</i></p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është i organizuar në module të formimit të përgjithshëm, të formimit karakterizues, të ngjashëm dhe/ose integrues si edhe module formuese me zgjedhje, përveç praktikës mësimore profesionale dhe përgatitjes së diplomës, të cilat e kanë të përcaktuar qartë përmbajtjen e tyre, mënyrën e organizimit si edhe format e mësimdhënies.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi përcakton ngarkesën në kredite lidhur me praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, specifikisht tek kategoria D (18 ECTS ose 10%) - lëndë plotësuese ku përfshihet Praktikë pranë Sipërmarrjes dhe tek kategoria E (6 ECTS ose 3%) detyrime përmbyllëse, në përputhje me specifikimet ligjore.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf; Evidenca 2.1.aTabela dhe plani mësimor MB; Evidenca 2.1.b.plani mësimor MB; Evidenca 42.Ligji për Arsimin e Lartë 2015..pdf; Evidenca 43.VKM 412,viti 2018; Evidenca 43.a.VKM 879,viti 2019]</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në kreun V-së të rregullores së programit të studimit përcaktohen kriteret e pranimit të studentëve, dokumentacioni, dhe format e publikimit të informacionit për pranimet. GVJ konstaton se IAL Barleti përmbush specifikat ligjore (neni 74 Ligji nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.41 datë 24.01.2018) lidhur me pranimin e studentëve në programin e studimit.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf; Evidenca 42.Ligji për Arsimin e Lartë 2015..pdf; Evidenca 43.VKM 41,viti 2018]</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për programin e studimit që po akreditohet.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Kodifikimi i programit të studimit nuk është bërë ende. IAL Barleti është në pritje të akteve nënligjore për zbatimin e vendimit nr. 310 datë 11.05.2022.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 42.Ligji për Arsimin e Lartë 2015..pdf Evidenca 45. Vendimi 310,dt 11.05.2022.Kodifikimi.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>IAL Barleti e ka synim dhe objektiv të qënësishëm të ardhshëm ofrimin e programeve të përbashkëta në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë publike ose private sipas legjislacionit në fuqi në kuadër të bashkëpunimit me synim krijimin e eksperiencave si dhe zhvillimin e aftësive dhe njohurive të reja. Këto synime dhe objekta janë të parashtruara në dokumentacionin rregullator të IAL-së, specifikisht tek Strategjia e Zhvillimit Institucional dhe tek neni 44 i Statutit.</p>





	[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.1.Statuti UniBa.pdf;Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional UniBa.pdf;]		
Konkluzione	GVJ, pasi analizoi programin e studimit, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe pas diskutimeve me stafin akademik të institucionin, gjykon se programi që vlerësohet realizon formimin e shprehive të veçanta dhe aftësimin e profesionistëve të ardhshëm me qëllim që t'iu përgjigjet më mirë nevojave të tregut, mbështetur edhe në eksperiencën e institucionit. GVJ konstaton se programi Bachelor në "Menaxhim Biznesi" ofron njohuri të përparuara në fushën e studimit, përfundim i cili mbështetet nga peshja e lëndëve të disiplinave karakterizuese (53%) si edhe nga larmishmëria e tyre. GVJ gjykon që programi i studimit që vlerësohet, nëpërmjet veprimtarive formuese të tij, ndikon në arritjen e objektivave akademike të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë pranë IAL Barleti është Njësia Kryesore përgjegjëse për programin e studimit në akreditim. Ky fakultet është krijuar me VKM nr.571 datë 12.08.2005 "Dhënie leje për hapjen e institucionit", riorganizuar sipas urdhërit të MASR nr.511 datë 24.10.2019 "Për Riorganizimin Institucional", gjithashtu sipas urdhërit të MASR nr.213 datë 03.07.2020 "Riorganizimi për ndryshimin e statusit", përbëhet nga tre Departamente, ndër të cilët Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës është Njësia Bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi". Organizimi dhe struktura e fakultetit është në përputhje të plotë me nenin 23 të Ligjit 80/2015. IAL është akredituar sipas VBA nr.9 datë 07.04.2017 dhe riakredituar sipas VBA nr.60 datë 16.12.2021.</p> <p>Struktura akademike përputhet plotësisht me misionin, qëllimin dhe objektivat e Programit që vlerësohet. Organizimi i saj mbështet plotësisht aktivitetin akademik si edhe operacional. Stafit akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore.</p> <p>15.4 % e stafit akademik të angazhuar në këtë program është i kualifikimit më të lartë, Profesor dhe Profesor i Asociuar. 50 % e stafit</p>




të angazhuar është me gradën Doktor, ndërsa 34.6% e stafit të angazhuar, është me gradën Msc. Konkretisht:

Për vitin akademik 2022-2023:

Personeli akademik i brendshëm i angazhuar në këtë program studimi (PAE) rezulton se është (13 gjithsej) ndërsa Personeli akademik i jashtëm (PAK) rezulton se është (13 gjithsej) me këto kualifikime:

Titulli/Grada	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1
Prof As	2	-
Dr	5	8
Msc	5	4

Raporti është 50 % PAE dhe 50 % PAK

Për vitin akademik 2021-2022:

Personeli akademik i brendshëm i angazhuar në këtë program studimi (PAE) rezulton se është (13 gjithsej) ndërsa Personeli akademik i jashtëm (PAK) rezulton se është (20 gjithsej) me këto kualifikime:

Titulli/Grada	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1
Prof As	1	2
Dr	4	13
Msc	7	4

Raporti është 39.4 % PAE dhe 60.6 % PAK

Për vitin akademik 2020-2021:

Personeli akademik i brendshëm i angazhuar në këtë program studimi (PAE) rezulton se është (10 gjithsej) ndërsa Personeli akademik i jashtëm (PAK) rezulton se është (17 gjithsej) me këto kualifikime:

Titulli/Grada	PAE	PAK
Prof.Dr	2	1
Prof As	2	2
Dr	3	9
Msc	3	5

Raporti është 37 % PAE dhe 63 % PAK

Për vitin akademik 2019-2020:

Personeli akademik i brendshëm i angazhuar në këtë program studimi (PAE) rezulton se është (7 gjithsej) ndërsa Personeli akademik i jashtëm (PAK) rezulton se është (13 gjithsej) me këto kualifikime:

Titulli/Grada	PAE	PAK
Prof.Dr	1	2
Prof As	1	1
Dr	4	5
Msc	1	5


	<p>Raporti është 35 % PAE dhe 65 % PAK</p> <p>Njësia bazë merr të gjitha masat për të garantuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe shkencor të stafit, e cila realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Seminareve dhe trajnimeve të organizuara nga njësia. ▪ Pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. ▪ Pjesëmarrjes në projekte ▪ Shkëmbimeve akademike nëpërmjet projektit Erasmus. <p>Çdo udhëtim apo pjesëmarrje sjell praktika të reja mësimdhënie, të cilat ju bëhen të njohura të gjithë anëtarëve të stafit nëpërmjet raporteve që plotësohen nga secili përfutues, pas kthimit nga aktiviteti. Këto praktika diskutohen në departament dhe ndihmojnë njësinë për të krijuar dhe zbatuar metoda të reja novatore.</p> <p>Diskutimet me stafin gjatë vizitës në institucion përforcuan opinionin se mobiliteti i stafit është një mënyrë shumë e mirë për rritje dhe zhvillim.</p> <p>GVJ, pasi analizoi dokumentacionin, gjykon që Njësia bazë, përgjegjëse për programin që vlerësohet, i përmbush kryesisht detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. <i>Vërehet se raporti PAE/PAK është rregulluar vetëm vitin e fundit akademik (2022-2023, 50 % PAE dhe 50 % PAK). Duhet të qartësohet një mospërputhje lidhur me numrin e stafit për vitin akademik 2021-2022 pasi tek evidenca nr.23 të dhëna tabelore për tre vitet e e fundit aneks tabela 1 evidenton 34 staf akademik gjithsej (pae dhe pak- Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës) ndërsa tek evidenca nr.24 tek aneks tabela 6.1 janë gjithsej 33 staf akademik. Gjithashtu, edhe për vitin akademik 2020-2021, tek evidenca nr.23 të dhëna tabelore për tre vitet e e fundit aneks tabela 2 evidenton 26 staf akademik gjithsej (pae dhe pak -Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës) ndërsa tek evidenca nr.24 tek aneks tabela 6.2 janë gjithsej 27 staf akademik.</i></p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.1.Statuti UniBa.pdf; Evidenca 1. Rregulloret e Fakultetit.pdf; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf; Evidenca 1.3.Rregullore e Departamentit Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave.pdf; Evidenca 24.Personeli akademik ,tabela 6.1.pdf; Evidenca 23.Të dhëna tabelore për 3 vitet e fundit,tab.1 dhe 2]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Departamenti si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në procesin e zhvillimit të praktikave mësimore sipas dokumentit Paketa e Praktikës (evidenca 2.3) specifikon se në fillim të semestrit studenti në bashkëpunim me pedagogun e praktikës përzgjedhin institucionin ku studenti do të zhvillojë praktikën si dhe objektivat për tu përmbushur gjatë periudhës së praktikës. Për këtë program studimi ky kriter nuk aplikohet pasi për praktikën mësimore angazhohet personel akademik, ndërsa programi i studimit nuk përfshin praktika laboratorike e klinike.</p>

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>[Referenca: Evidenca 2.3.UniBa Paketa e Praktikës.pdf]</p> <p>Njësia kryesore i kushton rëndësi të veçantë përgatitjes së dokumentacionit i cili udhëheq veprimtarinë e institucionit. Shqyrtimi i dokumentacionit të Njesisë bazë (neni 6), si dhe veçanërisht i Rregullores së institucionit (neni 25), konfirmojnë se koordinatori i departamentit koordinon punën në departament dhe asiston Përgjegjësën e Departamentit për mbarëvajtjen dhe realizimin e punëve në departament. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga UniBa (evidenca 47, vendimi numër 29 datë 14.10.2022 për emërim në detyrë të koordinatorit të departamentit të ekonomisë sipërmarrjes dhe financës) koordinatori i departamentit emërohet me urdhër të Rektorit të institucionit. GVJ vëren se ka një koordinator departamenti përgjegjës për programet e studimit që mbulon njësia bazë, roli i të cilit është të asistojë përgjegjësën e departamentit për organizimin, koordinimin dhe mbikqyrjen e punës për zhvillimin e programeve të studimit, <i>por jo një koordinator të përzgjedhur specifikisht si përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. GVJ sugjeron emërimin e koordinatorit të programit të studimit sipas kërkesave të këtij kriteri.</i></p> <p>[RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf; Evidenca 1.3.Rregullore e Departamentit Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave.pdf; Evidenca 47.Vendimi 21, Për emërim i koordinatorit të Dep.Ekonomisë.pdf]</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p>Vërehet se raporti PAE/PAK është rregulluar vetëm vitin e fundit akademik (2022-2023, 50 % PAE dhe 50 % PAK). Duhet të qartësohet një mospërputhje lidhur me numrin e stafit për vitin akademik 2021-2022 pasi tek evidenca nr.23 të dhëna tabelore për tre vitet e e fundit aneks tabela 1 evidenton 34 staf akademik gjithsej (pae dhe pak-Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës) ndërsa tek evidenca nr.24 tek aneks tabela 6.1 janë gjithsej 33 staf akademik. Gjithashtu, edhe për vitin akademik 2020-2021, tek evidenca nr.23 të dhëna tabelore për tre vitet e e fundit aneks tabela 2 evidenton 26 staf akademik gjithsej (pae dhe pak -Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës) ndërsa tek evidenca nr.24 tek aneks tabela 6.2 janë gjithsej 27 staf akademik.</p> <p>GVJ sugjeron emërimin e koordinatorit të programit të studimit sipas kërkesave të kriterit 3 të këtij standardi.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 1653 810 1727">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="810 1653 1038 1727">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1038 1653 1273 1727">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1273 1653 1434 1727">Përmbushet jo plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo plotësisht		X		
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo plotësisht						
	X								

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------




Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.

Siç rezulton nga dokumentat themelore rregullore të hartuara nga institucioni dhe njësia bazë, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë ndërtuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi (Shkresa e MASH nr.2365 prot. Datë 12.04.2006 për miratimin e hapjes së Fakultetit të Shkencave Ekonomike pranë Universitetit Jopublik Marin Barleti me degët Menaxhim Biznesi dhe Financë Kontabilitet; UMAS nr. 554 datë 23.11.2016 Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Menaxhim Biznesi në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë; UMASH nr.288 datë 04.09.2009 “Për akreditimin pozitiv të institucionit dhe të programeve të studimit të SHLUP Universiteti Marin Barleti” (Akreditimi pozitiv i programit të studimit Menaxhim Biznesi)- Evidenca 2.1.c dhe evidence 2.1.d

Njësia bazë, Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, përgjegjës për programin Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, disponon informacionet e nevojshme, si ato që transmetohen nga strukturat eprore institucionale ashtu edhe ato që hartohen brenda departamentit, në përputhje me organigramën dhe organizimin hierarkik të prodhimit dhe qarkullimit të informacionit.

Legjislacioni udhëheqës (Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministrave) për veprimtarinë e Institucioneve të Arsimit të Lartë, analizohet në Rektorat dhe mbi këtë bazë, hartohen dokumentat kryesore rregullore në nivel fakulteti dhe më tej, departamenti. Ky dokumentacion përfshin vendime të brendshme, udhëzime, rregullore si edhe statuti, të cilat vijnë të protokolluara dhe sipas afateve nga rektorati, përcillen në dekanat, i cili realizon detyrat e tij, duke miratuar rregulloret përkatëse dhe përcjellë informacionin mbi vendimet dhe vlerësimet në të dy drejtimet.

Rregullorja e brendshme e departamentit (Rregullore e Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës- evidencia 1.3) miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.65 datë 13.04.2021. Rregullorja e Fakultetit (Rregullore e Fakultetit – evidencia 1), miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.66/7 datë 13.04.2021 përcaktojnë gjithashtu marrëdhëniet e departamentit me studentët.

GVJ konstaton se njësia bazë i kushton vëmendje përgatitjes së dokumentacionit rregullator dhe udhëhiqet në veprimtarinë e saj institucionale nga legjislacioni.

[RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1. Rregulloret e Fakultetit.pdf; Evidenca 1.1. Statuti UniBa.pdf; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf; Evidenca 1.3.Rregullore e Departamentit Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave. pdf; Evidenca 1.4.a.;1.4.b.;1.4.c.;1.4.d.;1.4.e;Hapja, Akreditimi dhe Riorganizimi i Uniba; 2.1.c:Licensimi i MB;Evidenca 2.1.d.Akreditimi i MB.pdf; Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional UniBa.pdf; Evidenca 42. Ligji për Arsimin e Lartë 2015..pdf]

Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.

GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është i mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit Institucional të UniBa 2020-2030, si edhe në Planet mësimore vjetore. Në këto dokumenta përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 180 ECTS për të fituar Diplomën Bachelor në Menaxhim Biznesi. Në këtë plan, ngarkesa e një viti akademik (60 ECTS) është llogaritur 1.500 orë, (60 ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% përfaqësojnë punë të pavarur.

Gjithashtu, Njësia Bazë ka përcaktuar të gjitha rregullat që kanë të bëjnë me frekuentimin, ndjekjen e programit si edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Këto element përveç se të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit (neni 7 Politika e frekuentimit), Rregulloren e programit (neni 8 Procedura per frekuentimin, Kreu III-vlerësimi i studentit) janë gjithashtu të përcaktuara në syllabusin e secilës lëndë.

Vlerësimi i dijeve të studentit ndahet në vlerësim të vazhduar dhe vlerësim përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar, në varësi të lëndës varion nga 25% - 50% të totalit të pikëve dhe konsiston në dy elementë:

- Aktivizimi dhe pjesëmarrja në seminare;
- Testi i ndërmjetëm (detyra kontrolli) dhe detyra e kursit.

Frekuentimi leksioneve në këtë program studimi është i detyrueshëm në masën 50% ndërsa frekuentimi i ushtrimeve/seminareve/praktikave/ është i detyrueshëm në masën 75%.


[RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1. Rregulloret e Fakultetit.pdf; Evidenca 2.1. a. Tabela dhe plani mësimor MB; Evidenca 2.1. b. plani mësimor MB; Evidenca 2.6.1. Programet lëndore (Syllabuset).pdf; Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MB.pdf; Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional UniBa.pdf;]

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Institucioni ka përpunuar informacione të detajuara, të cilat ju përcillen studentëve nëpërmjet disa dokumentave thelbësore, siç janë; Rregullorja e Programit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e brendshme e studimeve e Fakultetit si edhe Statuti i UniBa. IAL ka hartuar gjithashtu një manual (evidenca 18) i cili specifikon kushtet, procedurat dhe kriteret e rekrutimit, aplikimit, regjistrimit, dhe transferimit të studentëve. Lidhur me transferimet brenda të njëjtit cikël studimi, IAL ka gjithashtu një rregullore specifike (evidenca 19) ku evidentohen kushtet dhe procedurat e transferimeve.

Këto dokumenta përcaktojnë të gjithë elementët dhe mekanizmat e duhur për të rregulluar marrëdhëniet e studentëve me institucionin, në funksion të realizimit të qëllimit të tyre si: regjistrimi, ndjekja, përfundimi i studimeve dhe diplomimi në programin e studimit, Bachelor në “Menaxhim Biznesi”.

	<p>Kriteret për pranimin e studentëve në programin e studimit janë në përputhje me nenin 74 të ligjit 80/2015 të arsimit të lartë, me udhëzimet e përvitshme të MASR, në kriteret e parashikuara në Rregulloren e programit të studimit sipas nenit 4 pika 4 (afati dhe e drejta e studimeve), neni 5 (ndërprerja dhe rifillimi i studimeve), neni 6 (lëvizja e studentëve), neni 14 (kushtet për transferimet ndërmjet programeve), kreu V -pranimi i studentëve, neni 24 (kriteret e pranimit), neni 25 (dokumentacioni i pranimit), neni 26 (forma e publikimit të informacionit për pranimet). Këto çështje specifikohen gjithashtu edhe tek Statuti i UniBa, kreu IV “Organizimi i studimeve në Universitetin Barleti”, neni 43 (Forma e studimeve dhe pranimi në UniBa), pika 5, Kreu VI “Studentët”, neni 61 (Transferimi i studimeve dhe njehsimi i periudhave të studimit).</p> <p>Procesi i pranimit të studenteve bëhet mbi bazë të një transparence të plotë, ku kriteret e pranimit, afatet, lista e kandidatëve fitues etj. shpallen në mjedise publike dhe kandidati për student ka të drejtën e ankimit në strukturat përkatëse në rast nevojë.</p> <p><i>[RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.1.Statuti UniBa.pdf; 3.Rregullore e programit te studimit MB.pdf; Evidenca 18.Manual Rekrutim,Aplikim,Regjistrim dhe transferim.pdf; Evidenca 19. Rregullore për transferimin dhe regjistrimin në programet e dyta.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Analiza e Syllabuseve të detajuara të lëndëve dëshmon se informacioni mbi përmbajtjen dhe formën e organizimit të mësimdhënies, për secilën lëndë të programit, është i detajuar, i plotë dhe i lehtë për t’u përdorur. Syllabusi përmban: Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënësve, konceptet themelore, tematikën e secilës orë mësimi, formën e kontrollit të dijeve dhe literaturën. Formatet e syllabuseve përputhet me standardet e përcaktuara në VKM 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Syllabusi, i përgatitur nga pedagogu i lëndës, depozitohet i firmosur, tek Njësia Bazë, përpara fillimit të semestrit. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për prezantimin e syllabusit si edhe sqarimin e modaliteteve të ndjekjes së lëndës, në orën e parë të mësimi.</p> <p>GVJ konstaton se programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme në lidhje me kërkesat e kriterit 4.</p> <p><i>[RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 2.6.1.Programet lëndore (Syllabuset).pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Me qëllim plotësimin më të mirë të nevojave të tregut, departamenti si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit duke i bërë përpjekjet për përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm të programit të studimit pjesë të planit vjetor të punës së departamentit. Shefi i departamentit i kërkon anëtarëve të departamentit propozime lidhur me përditësimet për literaturën e lëndëve dhe moduleve të programit të studimit si dhe për metodat e mësimdhënies. Gjithashtu bazuar në rregulloren e institucionit si dhe sipas vizitës në institucion Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë ka detyra thelbësore për të mbështetur</p>




	<p>procesin e përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të programit të studimit.</p> <p>[RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf; Evidenca 35. Analiza Vjetore e Dep.Ekonomisë për 2021-2022;Evidenca 35.a.Plan pune e Dep. për 2022-2023 (2).pdf]</p>		
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se njësia bazë i kushton vëmendje përgatitjes së dokumentacionit rregullator dhe udhëhiqet në veprimtarinë e saj institucionale nga legjislacioni.</p>		
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi II.4


Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programin që po vlerësohet, Bsc në “Menaxhim Biznesi” është ndërtuar sipas 5 drejtimeve themelore, përkatësisht Lëndë Bazë, Karakterizuese, Ndërdisciplinore dhe me zgjedhje, Plotësuese dhe Detyrime Përmbjllëse, në përmbajtjen e të cilave janë klasifikuar lëndët në aktivitete formuese dhe aktivitete praktike, në funksion të programit të studimit si edhe për të rritur mundësitë e punësimin të studentëve, nëpërmjet rritjes së nivelit profesional të tyre.</p> <p>Të gjitha veprimtaritë akademike si mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime si dhe kontrolli i vazhdueshëm) janë në funksion të arritjes të objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Metodot e mësimdhënies mbështetin të mësuarit interaktiv si edhe nxitjen e mendimit të tyre krijues.</p> <p>Bashkëpunimi me organizatat e biznesit nëpërmjet të ftuarve dhe/ose vizitave mbështet tranzicionin e studentëve nga shkolla në tregun e punës. Zhvillimi i praktikës mësimore gjatë një semestri ka ndikuar në rritjen e efektivitetit të tyre.</p> <p>[RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 2.1.aTabela dhe plani mësimor MB;Evidenca 2.1.b.plani mësimor MB; Evidenca 22.Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave</p>	<p>Siç konstatohet nga Plani mësimor si edhe nga diskutimet në institucion, shpërndarja e lëndëve ndërmjet viteve dhe semestrave synon të ofrojë njohuri gradualisht të përshkallëzuara. Kështu, në vitin e parë dhe të dytë ofrohen kryesisht disiplinat e njohurive të</p>

<p>formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>përgjithshme, ndërsa në vitin e tretë sigurohen njohuritë e detajuara profesionale.</p> <p>Planet mësimore si edhe dokumentat plotësuese për vitin akademik 2021-2022 sigurojnë informacion të mjaftueshëm dhe të detajuar mbi ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 180 ECTS për të fituar Diplomën Bachelor. Ngarkesa e një viti akademik (60ECTS) është llogaritur 1.500 orë, (60ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% përfaqësojnë punë të pavarur.</p> <p><i>[RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 2.1.aTabela dhe plani mësimor MB;Evidenca 2.1.b.plani mësimor MB; Evidenca 22.Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit.pdf; Evidenca 24.Personeli akademik ,tabela 6.1.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Informacioni i siguruar nga shqyrtimi i Rregullores së Departamentit dhe të programit të studimit konfirmon se ky program studimi ju siguron studentëve Diplomë Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, në sajë të së cilës ata mund të ushtrojnë profesionin si specialistë dhe menaxherë për kompani e organizata të ndryshme publike dhe private, specialistë në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, menaxherë operacionesh, menaxherë cilësie, dhe menaxherë projektesh.</p> <p>Programi i studimit është ndërtuar plotësisht në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij si edhe profilin përkatës. Planin mësimor përveç argumentave të mbështetura në analizën e kriterëve të standardit II.1, II.2 dhe II.3, shërben gjithashtu për të verifikuar mënyrën e organizimit të lëndëve të përgjithshme ndaj lëndëve specifike të profesionit. Siç konstatohet, lëndët e profesionit kryesisht realizohen në vitin e tretë të studimeve, së bashku me detyrimet përfundimtare, Diplomën ose provimin e Përgjithshëm Përfundimtar. Ndonëse raporti teori/praktikë në kuadrin e çdo lënde është në përputhje të plotë me profilin e programit, në kuadrin e përgjithshëm të studimeve, vlerësimi i praktikës në kohë dhe nëpërmjet krediteve, thekson natyrën praktike dhe efektive të njohurive të siguruar, duke rritur vlefshmërinë e diplomës së përfutur.</p> <p>GVJ konkludon se struktura e programit i përafrohet programeve të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>[RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 2.1.aTabela dhe plani mësimor MB;Evidenca 2.1.b.plani mësimor MB; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf; Evidenca 4.Studimi periodik i treguar të punës MB.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,</p>	<p>Objektivat formuese të programit, të specifikuar tek Rregullorja e Programit dhe Rregullorja e Departamentit, janë plotësisht të mbështetura nga struktura dhe organizimi i planit mësimor. Objektivat formuese të secilës lëndë janë të formuluar në mënyrë të qartë tek syllabuset përkatëse. GVJ gjykon që arritja e objektivave formuese në</p>


<p>mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>çdo lëndë është e mbështetur nga struktura e lëndës, në veçanti nga ndarja ndërmjet veprimtarive formuese si sipas lëndëve ashtu edhe sipas programit të përgjithshëm të studimeve akademike në Menaxhim Biznesi cikli i parë. Strukturimi i programit të studimit mundëson gjithashtu edhe lehtësimin e transferimeve dhe lëvizshmërinë e studentëve mes IAL-ve brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>[RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 2.1.a Tabela dhe plani mësimor MB; Evidenca 2.1.b. plani mësimor MB; Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MB.pdf; Evidenca 2.6.1. Programet lëndore (Syllabuset).pdf; Evidenca 22. Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Përmirësimi i përmbajtjes së lëndëve dhe moduleve është objekt i diskutimit në departament, bazuar në diskutimet me personelin e departamentit. Këtij qëllimi i shërben eksperiencia e fituar nga pjesëmarrja në programe kualifikimi jashtë vendit e disa pedagogëve si edhe këmbimi i eksperiencës me disa universitete të cilat aplikojnë programe të ngjashme.</p> <p>Programet e lëndëve përditësohen çdo vit akademik. Përditësimi përfshin literature bashkëkohore si në tituj edhe në vit botimi si edhe metoda më efektive e të përparuara të mësimdhënies. Ndryshimet në literature miratohen çdo vit akademik. Literatura e çdo lënde, si literature e detyrueshme, ashtu edhe ajo alternative, janë pjesë e syllabusit të lëndës.</p> <p><i>[RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 4. Studimi periodik i tregut të punës MB.pdf; Evidenca 30. Lista e teksteve në Bibliotekë.pdf; Evidenca 35. Analiza Vjetore e Dep. Ekonomisë për 2021-2022; Evidenca 35.a. Plan pune e Dep. për 2022-2023 (2).pdf; Evidenca 46. Raport Vjetor i kërkimit shkencor për vitin akademik 2021-2022.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njohurive të larmishme mbi menaxhimin e sipërmarrjeve të ndryshme private, menaxhimin e organizatave të ndryshme publike si dhe ato jo fitimprurëse, menaxhimin e operacioneve të biznesit, menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e projekteve etj.</p> <p>Njësia bazë konsideron nevojë parësore analizën e vazhdueshme të tregut, të cilën e ka realizuar dhe e ka përdorur për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies si edhe rritur efektivitetin e studimeve akademike, të konfirmuar nga pozicionimi në treg i studentëve dhe kariera e tyre.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 4. Studimi periodik i tregut të punës MB.pdf; Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose</p>	<p>Nisur nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Objektivat formuese të programit;

<p>punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Harmonizimi i lëndëve bazë dhe karakterizuese me ato me zgjedhje dhe plotësuese; ▪ Ndërthurja e njohurive teorike dhe praktike; ▪ Përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës; ▪ Përmirësimi i metodave të mësimdhënies; ▪ Kriteret e pranimit dhe transferimit <p>Nëpërmjet dokumentit Paketa e praktikës, IAL ka specifikuar mënyrën e zhvillimit të praktikës pranë sipërmarrjes si dhe rolin e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë process formues qe shërben si një urë lidhëse për studentin për të integruar teorinë e mvsuar në auditor me praktikën konkrete që shfaq tregu i punës. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Dekania e studentëve realizojnë takime me studentët e diplomuar në IAL Barleti, për tu mbështetur në eksperiencën e tyre si një burim i rëndësishëm informacioni që mundëson përshtatjen me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>GVJ mbështet përfundimin se program i studimit jo vetëm mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve, por edhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Njësia bazë i kushton vëmëndje të veçantë përmirësimit të përmbajtjes së programeve të studimit, gjë e cila konstatohet nga dokumentacioni udhëzues i përgatitur nga institucioni, mbi kriteret dhe formatin e syllabuseve, si edhe materialet didaktike të nevojshme që duhet të përfshihen në mënyrë të detyrueshme në syllabus.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 2.3.UniBa Paketa e Praktikës.pdf; Evidenca 4.Studimi periodik i tregut të punës MB.pdf; Evidenca 5.Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf; Evidenca 16.2.Rregullore e njësisë së përcaktuar të kurrikulave dhe cilësisë.pdf; Evidenca 43.VKM 412,viti 2018; Evidenca 43.a.VKM 879,viti 2019; Evidenca 43.b.VKM 185,viti 2021.pdf; Evidenca 22.2.Raportim vjetor Alumni ;Evidenca 22.3.Të dhëna për diplomim dhe punësim; Evidenca 22.4.Lista e praktikave të studentëve.pdf]</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konkludon se struktura e programit i përafrohet programeve të ngjashme ndërkombëtare. GVJ mbështet përfundimin se program i studimit jo vetëm mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve, por edhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 1747 805 1814">Përbushet plotësisht</th> <th data-bbox="805 1747 1037 1814">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1037 1747 1260 1814">Përbushet</th> <th data-bbox="1260 1747 1420 1814">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet	Përbushet plotësisht						
			X						




Standardi II.5
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave si njësi bazë e programit të studimit implementon disa instrumenta për të garantuar përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. Lidhur e me aktorët e brendshëm departamenti në bashkëpunim me Njësinë për Zhvillimin Kurrikulave dhe Cilësisë realizon pyetësorin me studentët në fund të vitit akademik për të evidentuar përmirësimet potenciales të evidentuara nga zëri i studentëve. Këndvështrimet e aktorëve të tjerë si institucionet partnere, konkurenca dhe ecuria e dinamikës së tregut janë pjesë e analizës së tregut që bën institucioni si dhe pjesë e analizës që i paraprin formulimit nga ana e institucionit të strategjisë për zhvillimin e programit të studimit. Bordi i Karrierës si dhe integrimi i eksperiencave Erasmus të stafit dhe studentëve janë dy instrumenta të tjerë që i shërbejnë procesit të përmirësimin dhe përshtatjes së programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 4.Studimi periodik i treguar të punës MB.pdf; Evidenca 5.Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf; Ev. 16.4.Formularë vler.lëndës dhe ped; Evidenca 16.7.Raport mbi rezultatet e formular studentit sem.1;Ev.16.8.Raport mbi rezultatet e formular vl.studenti sem.2.pdf; Evidenca 28.Vendim për ngritjen e bordit të karrierës.pdf;Evidenca 32.b.]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit.</p>	<p>Pjesë e strategjisë së zhvillimit të programit të studimit është koncepti “studenti ambassador”. Gjithashtu sipas neneve 36 dhe 37 të rregullores së institucionit përfshirja e studentëve dhe integrimi i mendimit të tyre në kontekstin e reflektimit dhe përfshirjes së tyre realizohet nga komunikimi me Dekanin e studentëve. Pyetësorin me studentët në fund të vitit akademik nëpërmjet bashkëpunimit të departamentit me Njësinë për Zhvillimin Kurrikulave dhe Cilësisë përfaqëson një tjetër formë të përfshirjes së studentëve.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf; Evidenca 5.Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf; Ev. 16.4.Formularë vler.lëndës dhe ped; Evidenca 16.7.Raport mbi rezultatet e formular studentit sem.1;Ev.16.8.Raport mbi rezultatet e formular vl.studenti sem.2.pdf; Evidenca 28.Vendim për ngritjen e bordit të karrierës.pdf;Evidenca 32.b.]</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete</p>	<p>Bashkëpunimi me studentët Alumni si dhe marrëdhënie e qëndrueshme me institucionet partnere nga tregu i punës me të cilat UniBa ka marrëveshje krijojnë mundësinë që Departamenti si njësi bazë përgjegjëse për përmirësimin, përditësimin, dhe përshtatjen e programit të studimit të marrë feedbackun e duhur për të ndërmarrë</p>





profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	strategjitë dhe hapat e duhur drejt procesit të përditësimit me ndryshimet e kërkuara. [Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf; Evidenca 5.Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf; Ev. 16.4.Formularë vler.lëndës dhe ped; Evidenca 16.7.Raport mbi rezultatet e formular studentit sem.1;Ev.16.8.Raport mbi rezultatet e formular vl.studentit sem.2.pdf; Evidenca 22.Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit.pdf; Evidenca 22.2.Raportim vjetor Alumni ;Evidenca 22.3.Të dhëna për diplomim dhe punësim; Evidenca 22.4.Lista e praktikave të studenteve.pdf; Evidenca 28.Vendim për ngritjen e bordit të karrierës.pdf;Evidenca 32.b.]		
Konkluzione			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” format kryesore të mësimdhënies dhe mësimnxënies janë: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Leksionet (840 orë totale në auditor) ✓ Seminarët (389 orë totale në auditor) ✓ Projekte/Detyra Kursi ✓ Praktika profesionale ✓ Leksionet e hapura <p>Ndërsa tre të parat janë pjesë e vlerësimit të lëndës, dy të fundit shërbejnë për konsolidimin e njohurive teorike dhe nëpërmjet tyre, krijimin e shprehive praktike.</p> <p>Këto metoda kryesore të mësimin janë përcaktuar edhe në dokumentat: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi, syllabusët e lëndëve.</p> <p>Përmirësimi i metodave të mësimdhënies përbën prioritet për njësinë (departamentin), dhe është reflektuar jo vetëm në dokumentat zyrtarë si: Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi, Analiza vjetore e departamentit dhe Udhëzuesi</p>




	<p>për metodat e mësimdhënies, por edhe në takimet e GVJ me drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit.</p> <p>GVJ konstatoi një përpjekje serioze nga ana e stafit në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies. Gjithashtu, pedagogët janë angazhuar për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësimin, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale. Kjo e fundit u pohua dhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimin të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gatishmërinë e pedagogëve për t'iu përgjigjur çdo pyetje e paqartësie të studentit.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf; Evidenca 2.1.a Tabela dhe plani mësimor MB; Evidenca 2.1.b.plani mësimor MB; Evidenca 2.6.1.Programet lëndore (Syllabuset).pdf; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf; Evidenca 5.Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf; Evidenca 11.Udhëzues për metodat e mësimdhënies.pdf Evidenca 35 .Analiza Vjetore e Dep.Ekonomisë për 2021-2022; Evidenca 35.a.Plan pune e Dep. për 2022-2023 (2).pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në përputhje me rregulloren mësimore, format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore, programet dhe syllabuset e lëndëve. Programi Bachelor në “Menaxhim Biznesi” përfshin format e mësimin teorik e praktik si leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit. Mënyra kryesore e vlerësimin të dijeve është provimi final i modulit, ndërsa të tjera përfshijnë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, dhe provimi i formimit ose mbrojtja e diplomës.</p> <p>Nga takimi që GVJ zhvilloi me studentët të programit u theksua se zhvillimi i orëve interaktive i lejon ata të përshihen më tepër dhe ndihmon mësimnxënien. Gjithashtu diskutimet dhe puna në grupe, krijimi i skenarëve të diskutimit nxisin të menduarit kritik.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 2.1.a Tabela dhe plani mësimor MB; Evidenca 2.1.b.plani mësimor MB; Evidenca 2.6.1.Programet lëndore (Syllabuset).pdf; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf; Evidenca 5.Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.</p>	<p>Institucioni trajnon në mënyrë të vazhdueshme pedagogët mbi specifikat e rregullores, metodat didaktike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore. Në kuadër të respektimit dhe vlerësimin të lirisë akademike, stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënien me module interaktive dhe forma që nxisin debatin dhe zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve.</p> <p>Institucioni mundëson kualifikime të vazhdueshme për stafin akademik si brenda dhe jashtë vendit. Personeli akademik angazhohet</p>

	<p>në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe jashtë vendit, ku nëpërmjet vizitave dhe shkëmbimeve në institucionet e huaja universitare, u mundëson ndjekjen e zhvillimeve më të fundit të fushës.</p> <p>Institucioni konsideron me përparësi identifikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe sigurimin e zbatimit të tyre në të gjithë procesin akademik, duke hartuar dhe një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e tyre.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 5.Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MB.pdf; Evidenca 8.Politikat e zhvillimit të stafit akademik.pdf; Evidenca 11.Udhëzues për metodat e mësimdhënies.pdf; Evidenca 21.Relacion për kërkimin shkencor.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të personelit akademik, të angazhuar në mësimdhënien në programin Bachelor në “Administrim Biznesi” u vu re se në tërësi fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar. Personeli akademik është i angazhuar në kërkim shkencor. Fusha kërkimore shkencore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve të tyre të mësimdhënies. Rezultatet e punës kërkimore shkencore paraqiten në botime brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Nga takimi që GVJ realizoi me stafin akademik dhe studentët, evidentoi se mësimdhënia është interaktive duke inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithë studentëve në diskutim. Përdorimi i rasteve të studimit me tematika aktuale dhe integrimi i literaturës ndërkombëtare krijon interes dhe përfshirje të studentëve në zgjidhje analitike të rasteve të huaja dhe vendase.</p> <p>Metodat interaktive të mësimdhënies përqëndrohen tek mundësitë dhe interesat e studentëve. Personeli akademik i programit të studimit nxit studentët të ndërmarrin iniciativa të lira dhe të pavarura në ngritjen e grupeve të punës, zgjedhjen e temave, përgatitjen e detyrave të kursit në të cilat vlerësohen dhe mbi bazën e iniciativës dhe krijimtarisë së tyre, bashkëpunim në zgjidhjen e problemeve në seminare etj.</p> <p>Bashkëpunimi i ndërsjellë pedagog-studentë vihet re në auditor, në detyrat e ndryshme të kursit, në projekte kërkimi edhe në mbikqyrjen e praktikës mësimore, realizimi i të cilës mundësohet në sajë të kontakteve dhe bashkëpunimeve të Institucionit me institucionet publike dhe jo publike.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 7.2.Cv e stafit akademik.pdf; Evidenca 21.Relacion për kërkimin shkencor.pdf; Evidenca 22.Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e</p>	<p>Institucioni ka ndërtuar disa instrumenta që përdoren për përmirësimin e veprimtarisë mësimore. Drejtuesit e departamenteve apo Dekani vëzhgojnë nga afër mënyrën e kryerjes së mësimin,</p>

metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.

vecanërisht për personelin akademik lektorë dhe asistentë lektorë, japin mendime e sugjerime, si dhe shkëmbejnë eksperiencë. Performanca e personelit akademik vlerësohet edhe duke marrë shqetësimet apo sugjerimet e studentëve, përmes përdorimit të fokus grupeve, pyetësorëve anonimë dhe bisedave që realizohen në mbledhjet e hapura të departamentit.

Konkluzionet e marra nga këto vlerësime i shërbejnë procesit të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulave, metodave të mësimdhënies si dhe përmirësimit të komunikimit e bashkëpunimit me studentët. Në këtë proces të monitorimit të procesit mësimor luan rol të rëndësishëm NJZHKC apo Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë. NJZHKC në mënyrë semestrale, realizon fokus grupe dhe dërgon një pyetësor tek të gjithë studentët për të marrë opinionin e tyre lidhur me format dhe metodat e mësimdhënies si dhe vlerësimin e dijeve. NJZHKC i përdor këto rezultate të studentëve në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor.

[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 16.2.Rregullore e njësive të përcaktuara të kurrikulave dhe cilësisë.pdf; 16.4. Formularë vler. lëndës dhe ped; Ev. 16.5. Formularë për transp; Evidenca 48. Plani i punës NJZHKC; Evidenca 48.1. Të dhëna tabelore me anëtarët e NJZHKC.pdf]

Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.

Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, në nivel universiteti janë organizuar struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë.

Njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor- kërkimor janë:

- Komisioni i Vlerësimit të Performancës
- Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë
- Struktura e Njësive e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë

Veprimtaria e NJZHKC përfshin monitorimin, vlerësimin dhe zhvillimin e përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë së Institucionit. Funksionet kryesore të saja janë:

- Organizon në bashkëpunim me Zv. Rektorin Akademik proceset e monitorimit të aktiviteteve mësimore.
- Organizon në mënyrë semestrale pyetësorin me studentët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programeve të studimit.
- Organizon fokus grupe me studentët në lidhje me perspektivën e tyre ndaj procesit mësimor.
- Përcakton kriteret dhe procedurat e vlerësimit të veprimtarive kërkimore shkencore në bashkëpunim me Zv. Rektorin për Kërkimin Shkencor.

Institucioni ka krijuar një udhëzues për metodat e mësimdhënies në nivel institucional për përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie. Gjithashtu, Institucioni mundëson trajnime të ndryshme për personelin akademik që synojnë njohjen dhe përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie. Nga ana tjetër edhe pjesëmarrja në mobilitete sjell praktika të reja mësimdhënie, të cilat ndahen dhe diskutohen në


	<p>departament dhe ndihmojnë njësinë për të krijuar dhe zbatuar metoda të reja novatore.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 10.1.Strategjia e ndërkombëtarizimit e UniBa.pdf; Evidenca 11.Udhëzues për metodat e mësimdhënies.pdf; Evidenca 16.2.Rregullore e njësisë së përcaktuar të kurrikulave dhe cilësisë.pdf]</p>						
Konkluzione	<p>GVJ, pasi analizoi dokumentacionin përkatës si edhe diskutoi me stafin përgjegjës gjatë vizitës në institucion, konstaton se Institucioni i ka realizuar me përgjegjësi detyrimet e tij në lidhje me organizimin e strukturave në nivel institucional për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinuar dhe bashkërenduar aktivitetin e përgjithshëm në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu Institucioni përdor instrumenta dhe zbulon mekanizma të rinj në funksion të përdorimit të metodave innovative të mësimdhënies.</p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmubshet kryesisht</td> <td>Përmubshet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmubshet kryesisht	Përmubshet plotësisht			X
	Përmubshet kryesisht	Përmubshet plotësisht					
		X					

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Analiza paraprakisht e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe njësisë qartësisht tregoi se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse.</p> <p>Vizita në instucion, veçanërisht diskutimi me studentët konfirmoi vlerësimin se të gjitha kriteret dhe rregullat e mënyrat e testimit janë të njohura në sajë të publikimit në faqen e institucionit të planit mësimor, në syllabusin e lëndës si edhe informimit e sqarimit nëpërmjet strukturave të institucionit.</p> <p>GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve është i vazhdueshëm duke përfshirë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, provimi final i lëndës dhe provimi i përgjithshëm i formimit.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf, neni 83, faqe 38-39; Evidenca 2.6.1.Programet lëndore (Syllabuset).pdf; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf, neni 17, faqe 9; Evidenca 13.Rregulloret për provimet dhe testimet.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Në vijim të informacionit të dhënë tek kriteri 1 i këtij standardi, GVJ vlerëson se pedagogët i informojnë studentët në fillim të procesit mësimor me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe literaturën që do të përdoret në modulën përkatës. Gjithashtu programet e lëndëve, përfshirë edhe elementët e mësipërm janë pjesë</p>

<p>lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>e publikimit të secilit pedagog, nënfaqen përkatëse të sistemit të menaxhimit të të dhënave të studentëve, Classter.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf, neni 83, faqe 38-39; Evidenca 2.6.1.Programet lëndore (Syllabuset).pdf; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf, neni 17, faqe 9; Evidenca 13.Rregulloret për provimet dhe testimet.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstatoi se në Rregulloren e Institucionit dhe atë të studimeve në FEQD dhe njësinë bazë përcaktohen qartë se format e kontrollit të dijeve janë komplekse dhe të larmishme, përkatësisht nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aktivizimi në mësim • Testimi i ndërmjetëm. • Detyrat e kursit ose projekte. • Provimi final. <p>Studentët njihen qysh në fillim të semestrit me mënyrën e kontrollit të dijës dhe formën e organizimit të saj, në secilin modul.</p> <p>Sistemi i pikëzimit dhe i vlerësimit mbi bazën e pikëzimit është gjithashtu i standardizuar dhe i përcaktuar.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf, neni 83&85, faqe 38-39; Evidenca 2.6.1.Programet lëndore (Syllabuset).pdf; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf, neni 17, faqe 9; Evidenca 13.Rregulloret për provimet dhe testimet.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Mënyra e përfshirjes së studentëve në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies është nëpërmjet mbledhjes së mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve nga Dekani i Studentëve por edhe nëpërmjet metodologjive që implementon NJZHKC.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 11.Udhëzues për metodat e mësimdhënies.pdf; Evidenca 16.2.Rregullore e njesisë së përcaktuar të kurrikulave dhe cilësisë.pdf; Ev. 16.4.Formularë vler.lëndës dhe ped; Evidenca 16.7.Raport mbi rezultatet e formular studentit sem.1;Ev.16.8.Raport mbi rezultatet e formular vl.studentit sem.2.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>UniBa trajnon pedagogët e jashtëm e të brendshëm mbi specifikat e rregullores, metodat didaktike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore. Pjesë e rëndësishme e trajnimeve është përdorimi i sistemit të brendshëm të komunikimit me studentët, për sigurimin e materialeve teorike dhe vlerësimet e studentëve.</p> <p>Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike, stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënie me module interaktive dhe forma që nxisin debatin dhe zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në funksion të moduleve aplikative, UniBa ka në dispozicion salla kompjuterike të pajisura me programe kompjuterike bashkëkohore, ku studentët mund të mësojnë duke zgjidhur vetë raste e detyra praktike.</p> <p>Departamenti angazhon personelin akademik në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe jashtë vendit e cila i mundëson ndjekjen e</p>

	<p>zhvillimeve më të fundit të fushës. Institucioni konsideron me përparësi identifikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe sigurimin e zbatimit të tyre në të gjithë procesin akademik, duke hartuar dhe një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e tyre. Institucioni ka përgatitur dokumentin “Udhëzues për metodat e mësimdhënies”.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 2.1.b.plani mësimor MB; Evidenca 7.2.Cv e stafit akademik.pdf; Evidenca 8.Politikat e zhvillimit të stafit akademik.pdf; Evidenca 11.Udhëzues për metodat e mësimdhënies.pdf; Evidenca 31.Raport i ekspertit për infrastrukturën]</p>		
Konkluzione	<p>Analiza paraprakisht e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe njësisë qartësisht tregoi se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse. Institucioni konsideron me përparësi identifikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe sigurimin e zbatimit të tyre në të gjithë procesin akademik, duke hartuar dhe një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e tyre.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Dokumentacioni rregullator si edhe syllabuset e çdo lënde përcaktojnë qartë mënyrën e vlerësimit të studentit, e cila bazohet në vlerësimin e studentit në mënyrë të vazhduar. Vlerësimi përfundimtar i studentit përmbledh vlerësimin gjatë zhvillimit të moduleve (aktivizimi në mësim, provim i ndërmjetëm dhe detyra apo projekte kursi) dhe vlerësimin përmbyllës të çdo moduli (provimi përfundimtar i modulit).</p> <p>Është kompetencë e pedagogut që të përcaktojë raportin ndërmjet vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar, si edhe të informojë studentët, të cilët duhet të njohin jo vetëm mënyrën por edhe nivelin e përgjithshëm të pikëve paraprake, përpara se sa të përfundojë kursi përkatës. Vizita në institucion tregoi se nuk ekzistojnë paqartësi apo konflikte për këtë çështje.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; 1.2.Rregullore e UniBa.pdf, neni 83&85, faqe 38-39; Evidenca 2.6.1.Programet lëndore (Syllabuset).pdf; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf, neni 17, faqe 9; Evidenca 13.Rregulloret për provimet dhe testimet.pdf]</p>




<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka në plan për të ardhmen të përdor testimin online. Për momentin Institucioni mundëson vetëm vlerësimin e detyrave apo projekteve të kursit online. Gjatë periudhës së pandemisë Institucioni ka përdorur metoda të vlerësimit online për rezultatet e të nxënit. Këto metoda kanë përfshirë teste elektronike dhe quize online për përvetësimin e koncepteve kryesore të lëndëve si dhe portofolin digital që ka përfshirë bibliografi dhe Webliografi, ese apo ushtrime dhe detyra kursi, sipas programit lëndor. [Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 29.Guide instruktive e mesimit online]</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i moduleve që zhvillohen në këtë program studimi bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Siç është përmendur edhe në kriteret e mësipërme, vlerësimi përfundimtar i studentit përmbledh vlerësimin gjatë zhvillimit të moduleve (aktivizimi në mësim, provim i ndërmjetëm dhe detyra apo projekte kursi) dhe vlerësimin përmbyllës të çdo moduli (provimi përfundimtar i modulit, saktësuar në syllabuset e çdo moduli. Ashtu siç e përcakton edhe ligji për arsimin e lartë modulet e programit të studimit janë të vlerësuara në kredite (ECTS), të cilat student i fiton pasi ka marrë një vlerësim pozitiv të vlerësimit përfundimtar. [Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf, neni 17, faqe 9; Evidenca 42.Ligji për Arsimin e Lartë 2015..pdf; Evidenca 43.VKM 412,viti 2018;Evidenca 43.a.VKM 879,viti 2019;Evidenca 43.b.VKM 185,viti 2021.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbij procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i vazhduar dhe përmbyllës i çdo moduli njohurive shoqërohet me komente dhe argumentim për të ndihmuar studentin të kuptojë situatën e të nxënit dhe të përmirësohet. Studentët gjithashtu gëzojnë të drejtën e ankimit, pasi njihen me rezultatet e provimeve. Vizita në institucion ndihmoi GVJ të konkludojë se pedagogët e ushtrojnë kompetencën e tyre të vlerësimit në mënyrë të përgjegjshme dhe të ndërjegjshme. [Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf, neni 89-90, faqe 41; Evidenca 13.Rregulloret për provimet dhe testimet.pdf, neni 89-90]</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën. Së pari, personeli i ngarkuar me mbikqyrjen e provimit zbaton tërësisht rregulloren. Së dyti, komisioni i ngarkuar për vlerësimin jo vetëm zbaton rregulloren por ndërmerr edhe masa ndëshkimore në rast të shkeljes së saj. Kodi i Etikës, gjithashtu përcakton si elemente që përbëjnë shkelje disiplinore, plagjiaturën dhe kopjimin dhe masat që ndërmerren. [Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf, neni 111-112, faqe 48; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf, neni 31, faqe 12; Evidenca 33. Kodi i Etikës.pdf, neni 4 pika 6 & neni 6]</p>

<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Mbështetur në rregulloret përkatëse, përgjegjësi i departamentit kontrollon dhe miraton tezën, mbi bazën e të cilës kontrollohen dhe vlerësohen njohuritë dhe dijet e përfituara. Teza duhet të përfshijë të gjitha informacionet thelbësore të diskutuara në klasë gjatë zhvillimit të modulit.</p> <p>Gjithashtu, veprimet dhe detyrimet pas përfundimit të provimit dhe kontrollit të tij, janë të përcaktuara në rregullore. Fleta e vlerësimit të provimit përmbillet dorëzohet në Sekretari e plotësuar nga pedagogu i lëndës jo më vonë se 7 ditë nga dita e kryerjes së provimit. GVJ gjykon që institucioni përdor të gjitha instrumentat efektivë që të garantojë rezultate të bazuara mbi meritokracinë.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf, neni 88, faqe 40; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf, neni 19 & 20, faqe 10; Evidenca 13.Rregulloret për provimet dhe testimet.pdf, neni 88 & 91]</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ konstaton se jo vetëm nëpërmjet rregulloreve, por edhe si veprimtari praktike, e drejta e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe ankimuar atë në rast se ankimimi është i nevojshëm, është e garantuar dhe ushtrohet, brenda dy ditëve (48 orë) nga shpallja e rezultatit të vlerësimit. Pedagogu i lëndës apo komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni apo pedagogu i lëndës ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit.</p> <p>Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjigje sipas rregullave të përcaktuara. Në rast kur kërkesa e ankimit nuk gjen mbështetje nga pedagogu i lëndës apo komisioni i vlerësimit, student ka të drejtë t'i drejtojë një ankesë me shkrim drejtuesit të departamentit, i cili duke ndjekur procedurat përkatëse të përcaktuara në rregullore, ngre komisionin për shqyrtimin e kërkesës. Vendimi i marrë nga Komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës është përfundimtar dhe pas këtij momenti çështja mbyllet dhe arkivohet në Sekretari.</p> <p><i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf, neni 88, faqe 40, neni 90, faqe 40; Evidenca 3.Rregullore e programit të studimit MB.pdf, neni 19 & 20, faqe 10; Evidenca 13.Rregulloret për provimet dhe testimet.pdf, neni 88, 90 & 91]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se jo vetëm nëpërmjet rregulloreve, por edhe si veprimtari praktike, e drejta e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe ankimuar atë në rast se ankimimi është i nevojshëm, është e garantuar dhe ushtrohet. Vizita në institucion ndihmoi GVJ të konkludojë se pedagogët e ushtrojnë kompetencën e tyre të vlerësimit në mënyrë të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme. Vlerësimi</p>

	përfundimtar i moduleve që zhvillohen në këtë program studimi bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra). Lidhur me përmbajtjen e programit të studimit, përbëhet nga (1) lëndë bazë, (4) lëndë të formimit karakterizues (4) lëndë ndërdisiplinore dhe me zgjedhje, lëndë plotësuese përfshihet vetëm praktika profesionale dhe në detyrimet përmyllëse përfshihet provimi i përgjithshëm formimi.</p> <p>Programi ka përmbajtje të atillë që u ofron studentëve njohuritë bazë të nevojshme për profilin e programit, për të fituar aftësi dhe kompetenca në fushën e menaxhimit në organizata, menaxhimin e projekteve, menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e operacioneve të biznesit, etj. për të ndërtuar një karrierë të qëndrueshme në tregun e punës.</p> <p>GVJ konsideron të përshtatshme dhe efektive strukturën e programit si në raport me kërkesat bashkëkohore akademike ashtu edhe në raport me kërkesat e tregut lokal dhe rajonal të punës.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 2.1.c; Licensimi i MB; Evidenca 2.1.d. Akreditimi i MB.pdf]</p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	<p>Plani Mësimor siguron informacion të mjaftueshëm për të konfirmuar se program i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në teknologji (Teknologji Informacioni), shkencë humane dhe shoqërore (E Drejtë Publike, Sociologji), si dhe komunikimit dhe ndërveprimit (Sjellje Organizative, Etika e Biznesit).</p> <p>Veçanërisht me vlerë është organizimi dhe realizimi i praktikës profesionale në institucione, organizata dhe ndërmarrje publike dhe jo publike.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MB.pdf; Evidenca 2.1.a Tabela dhe plani mësimor MB]</p>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në programin e studimit paraqiten në syllabuset e çdo lënde. Vlerësimi dhe analizimi i tyre bëhet në bazë të statistikave të rezultateve të pyetësorit të studentëve, diskutimeve me studentët dhe vlerësimeve përfundimtare të lëndës të</p>

Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.

cilat analizohen nga pedagogu përkatës i lëndës dhe diskutohen në mbledhje të departamentit për reflektime të mëtejshme në përputhje me qëllimet e programit të studimit. Tregues statistikorë të mbledhur nga institucioni, që reflektojnë ecurinë e studentëve, gjithashtu konsiderohen për të argumentuar efektivitetin e programit të studimit.

Në përfundim të çdo moduli dhe semestri, pedagogët realizojnë një seance konsultuese ku orientojnë studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, struktura e përgjithshme e tezës dhe udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin përfundimtar.

[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 16.7.Raport mbi rezultatet e formular studentit sem.1;Ev.16.8.Raport mbi rezultatet e formular vl.studenti sem.2.pdf; Evidenca 26.2.Të dhëna të plota për regj,ecurinë.pdf; Evidenca 35 .Analiza Vjetore e Dep.Ekonomisë për 2021-2022]

Kriteri 4: Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.

Vizita në institucion, veçanërisht diskutimi me studentët, konfirmoi vlerësimin e GVJ, mbështetur në përshtypjet dhe deklaratimet mjaft pozitive të studentëve. Praktika profesionale iu mundëson studentëve të vendosin në praktikë kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të moduleve të programit.

Një nga mënyrat e vlerësimit të studentëve realizohet nëpërmjet bashkëpunimit dhe mbikqyrjes së përgatitjes të një detyre kursi ose projekti, të vlerësuar me 20 % të vlerësimit përfundimtar, në varësi nga specifikat e modulit si edhe vendimi i pedagogut përkatës. Detyrat e kursit shërbejnë si një bazë praktike shumë e rëndësishme për punën e temës së diplomës.

Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët sipas grupeve të punës në lidhje me realizimin e detyrës së caktuar dhe stimulon zgjidhjen e një problemi biznesi. Në këtë proces personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe identifikon fushat të cilat kanë nevojë për thellim teorik dhe studim të mëtejshëm. Institucioni mbështet studentët aty ku ka premisa për shndërrimin e ideve inovatore në një start up në të ardhmen. Njësisia, nga ana tjetër i krijon studentëve mundësi në përfshirjen e tyre në kërkime shkencore, studime të avancuara, bootcamps nëpërmjet instituteve dhe qëndrave të grupit Barleti. Gjithashtu institucioni është vazhdimisht aktiv në programin e këmbimeve akademike dhe kulturore, Erasmus.

[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 2.3.UniBa Paketa e Praktikës.pdf; Evidenca 2.6.1.Programet lëndore (Syllabuset).pdf; Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional UniBa.pdf; Evidenca 10.1.Strategjia e ndërkombëtarizimit e UniBa.pdf; Evidenca 32.b.;Evidenca 32.c.;Evidenca 32.d;Evidenca 32.e.pdf]

<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se njësia bazë bën përpjekje intensive që të ofrojë të rejat më të përditësuara të shkencës dhe teknologjisë si nëpërmjet leksioneve të hapura ashtu edhe organizimit të seminareve. Gjatë vitit akademik 2021-2022 janë realizuar disa leksione të hapura me pjesëmarrje të ekspertëve të njohur të vendit. Në këto aktivitete gama e çështjeve të trajtuara paraqitet e larmishme.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; https://umb.edu.al/neës-list/2021-2022/1.html]</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konsideron të përshtatshme dhe efektive strukturën e programit si në raport me kërkesat bashkëkohore akademike ashtu edhe në raport me kërkesat e tregut lokal dhe rajonal të punës.</p> <p>Vizita në institucion, veçanërisht diskutimi me studentët, konfirmoi vlerësimin e GVJ, mbështetur në përshtypjet dhe deklaratimet mjaft pozitive të studentëve. Praktika profesionale iu mundëson studentëve të vendosin në praktikë kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të moduleve të programit.</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 784 798 862">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="798 784 1013 862">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1013 784 1228 862">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="582 862 798 929"></td> <td data-bbox="798 862 1013 929"></td> <td data-bbox="1013 862 1228 929" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit, përshkruhet zhvillimi i procesit të diplomimit të studentëve të programit Bachelor në “Administrim Biznesi”. Për t’u diplomuar studenti duhet t’i nënshtrohet një provimi të përgjithshëm formimi, i cili përfshin çështje kryesore të moduleve të realizuara gjatë zhvillimit të programit. Kjo me përjashtim të studentëve me mesatare jo më të ulët se 9.5 të cilët mund të zgjedhin punim diplome.</p> <p>Mbrojtja e provës finale përcaktohet në kalendarin akademik, të cilin studentët e aksesojnë që në fillim të procesit mësimor edhe në faqen zyrtare të Universitetit. Gjithashtu, bazuar në rregulloren e Institucionit, Sekretaria kryen njoftimin e datës dhe orës të provës finale jo më pak se 2 javë përpara.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf, neni 99, faqe 44; Evidenca 2.5.Fondi i pyetjeve te provim formimi MB.pdf; Evidenca 3.Rregullore e programit te studimit MB.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Personeli akademik orientojnë studentët duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione dhe udhëzime për materialet e nevojshme që duhet të konsultojnë në përgatitjen e provimit final. Gjithashtu studentëve i vihat në dispozicion një fond i pyetjeve të provimit final.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 2.5.Fondi i pyetjeve te provim formimi MB.pdf]</p>

<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të zhvillojë një provim të përgjithshëm formimi, ku atij do ti duhet të aplikojë njohuritë kryesore të përfituara gjatë vitit të studimit për t'i dhënë përgjigje tre pyetjeve të tezës finale. Teza e Provimit përfundimtar synon të vlerësojë njohuri përgjithësuere sipas programit, kryesisht të lëndëve me peshë specifike më të konsiderueshme. Studentët orientohen dhe ndihmohen që të përgatiten për provimin përfundimtar. Studentëve i vihet në dispozicion një fond i pyetjeve të provimit final me çështje nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit.</p> <p>Departamenti propozon komisionin me jo më pak se tre anëtarë të Departamentit. Komisioni miratohet nga Dekani i Fakultetit. Vendimi i cili përmban edhe datën dhe orën e zhvillimit të provimit, dërgohet për veprim në Sekretari. Më pas sekretaria kryen njoftimin e datës dhe orës të proves finale jo më pak se 2 javë përpara.</p> <p>GVJ gjykon që procedura e ndjekur për paraqitjen dhe mbrojtjen e detyrimeve përmbyllëse është përshkruar qartë në rregulloret përkatëse, ndërsa njësia realizon detyrimet e saj për të informuar, ndihmuar, koordinuar dhe udhëhequr studentët drejt plotësimit të tyre.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf, neni 99; Evidenca 2.5.Fondi i pyetjeve te provim formimi MB.pdf; Evidenca 3.Rregullore e programit te studimit MB.pdf, neni 22]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Studentët e programit Bachelor në “Administrim Biznesi” i nënshtrohen një provimi të përgjithshëm formimi për sigurimin e diplomës. Me vendim Senati, tema e diplomës merret vetëm në rastin kur student i ka një mesatare mbi 9.5. Procedura për monitorimin, ndjekjen dhe udhëzimet e punimit të diplomës janë të shpjeguara në dokumentin Rregullore e Programit të studimit.</p> <p>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf, neni 99; Evidenca 3.Rregullore e programit te studimit MB.pdf, neni 22]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Siç është përmendur në kriterin e mësipërm, studentit e këtij programi studimi provën finale e mbyllin me provim të përgjithshëm formimi, përveç rastit me mesatare jo më të ulët se 9.5 kur studentët mund të zgjedhin punim diplome.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Rregullorja e brendshme e programit përcakton qartë mënyrën e vlerësimit të studentit pas përfundimit të detyrimeve përmbyllëse. Studentët e këtij programi studimi, në rast se mbyllin provën finale me provim formimi, tezat e provimit përgatiten nga departamentet dhe firmosen nga drejtuesi i tij. Sipas Rregullores së Programit studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit. Komisioni i ngritur për vlerësimin e studentëve në provën finale vlerëson me notë studentin sipas sistemit të vlerësimit të përcaktuar nga Institucioni.</p>



	<i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 3.Rregullore e programit te studimit MB.pdf]</i>		
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti që ka plotësuar të gjitha detyrimet e planit mësimor dhe ka mbrojtur me sukses provën finale (provim formimi ose punim diplome) pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës. Modeli i diplomës është hartuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Në përfundim të studimeve, me kërkesë të studentit, mund të vihet në dispozicion edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit. <i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 1.2.Rregullore e UniBa.pdf; Evidenca 3.Rregullore e programit te studimit MB.pdf; Evidenca 14.a Forma e diplomave MPAB.pdf]</i>		
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Dokumentacioni i studentëve ruhet nga institucioni për një periudhë të pacaktuar që nga koha e regjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve. Çdo dokumentacion është i arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. GVJ vizitoi nga afër arkivin e sekretaries mësimore ku verifikoi dosje të studentit, regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe vlerësoi angazhimin e institucionit në këtë drejtim. <i>[Referenca: RVB Menaxhim Biznesi.pdf; Vizita në institucion; Evidenca 14.a Forma e diplomave MPAB.pdf; Evidenca 19.1. Rregullore e sekretarise mesimore.pdf]</i>		
Konkluzione	<i>GVJ gjykon që procedura e ndjekur për paraqitjen dhe mbrojtjen e detyrimeve përmblylëse është përshkruar qartë në rregulloret përkatëse, ndërsa njësia realizon detyrimet e saj për të informuar, ndihmuar, koordinuar dhe udhëhequr studentët drejt plotësimit të tyre. Dokumentacioni i studentëve ruhet nga Institucioni për një periudhë të pacaktuar që nga koha e regjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X
---	-----------------------------	------------------------------	----------

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Kërkesat ligjore në fuqi për stafin akademik përcaktohen me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në zbatim të tij si dhe të Statutit të UniBa e Rregullores, përbërja e stafit akademik është e tillë që përmban staf me titullin minimal Master shkencor.</p> <p>Aktualisht numri i stafit akademik efektiv të departamentit DESF, është 13 pedagogë, nga të cilët 1 me gradën Prof. Dr, 2 me gradën Prof. Asoc. Dr., 5 me gradën Dr dhe 5 me gradën Msc. Ndër stafin akademik me kontratë (PAK), 1 prej tyre është aktualisht Prof. Dr., 8 me gradën Dr dhe 4 janë MsC. Ndërsa gjithë stafi I programit të studimit për vitin 2022-2023 përbëhet nga 19 pedagogë (tabela 12 në anekse, të cilat tregojnë stafin akademik të programit prej 5 vitesh), prej të cilëve sipas gradave janë 2 Prof. asoc. Dr. 10 Dr., dhe 15 prej tyre janë PAE ndërsa 4 janë PAK. Ky raport ka qenë relativisht I qëndrueshëm në tre vitet e fundit, sipas tabelës 7 në Aneksat përkatëse Informacion më i detajuar mbi titujt dhe gradat shkencore gjendet në tabelën të anekseve mbi stafin akademik. Stafi i programit i përmbush kriteret ligjore për ekspertizën në fushën kërkimore dhe eksperiencën praktike lidhur me programin e studimit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 23 Të dhëna tabelore për tre vitet e fundit personeli akademik.pdf; Evidenca 23.1. Të dhëna tabelore për lëndët me ngarkesën.pdf, Evidenca 7.2 CV e stafit akademik.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Udhëzimet e MAS, Rregulloret dhe statuti i UniBa, përgatitet në mënyrë të përvitshme, ngarkesa e stafit akademik, në çdo fillim viti akademik nga Departamenti dhe përgjegjësi I departamentit. Ngarkesa propozohet nga DESF dhe miratohet nga Senati Akademik, duke u bazuar në udhëzimet e rektorit të dërguara në cdo fillim viti akademik. Personeli akademik efektiv mbulon 70% të ngarkesës. Ngarkesa e stafit përcaktohet bazuar mbi titujt akademikë dhe gjithashtu udhëzimet dhe rregulloret për orët e zhvilluara mbi normë, të cilat nuk mund të jenë më shumë se 200 orë dhe në raste të vecanta me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, mund të jetë edhe 100 orë më tepër.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 2.1.d Udhëzim 1309/1 dt 14.10.2022 “Lista e stafit akademik për vitin 2022-2023 në Universitetin Barleti.pdf; Evidenca 23.1. Të dhëna tabelore për lëndët me ngarkesën.pdf, Evidenca 44 procedura për monitorimin e fillimit të procesit mësimor.pdf]</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Stafi i departamentit dhe i programit të studimit është relativisht i qëndrueshëm, për disa vite. Gjithë stafi akademik është i punësuar me kontratë të përhershme ose të përkohshme sipas kategorive dhe kushteve të departamentit dhe programit të studimit.</p> <p>Kontratat e punësimit dhe mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetësore realizohen duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, duke përfshirë Ligjin për arsimin e lartë, 80/25 dhe Ligjin për Sigurimet Shoqërore në RSH si edhe Kodin e punës, sipas të cilave bëhet edhe përlllogaritja e deklarimeve të të gjitha kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve. Procedurat për rekrutimin e personelit akademik në përgjithësi sidhe për programin e studimit janë të qarta dhe përfshijnë kontratat në punësimit si PAE ose si PAK.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 7.3 kontrata e stafit akademik.pdf; Evidenca 23.1. Të dhëna tabelore për lëndët me ngarkesën.pdf, Evidenca 23 Të dhëna tabelore për tre vitet e fundit personeli akademik.pdf, Evidenca 7 Manual i Menaxhimit të BNJ.pdf, vizita në institucion, në Zyrën e burimeve Njerëzore.]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UniBa ka hartuar “Manualin e menaxhimit të burimeve Njerëzore”, e cila bazohet në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë, Kodin e Punës në RSH, statutin dhe rregulloren e UniBa. Evidentimi i nevojave për personel akademik si dhe ndihmës akademik e administrative bëhet cdo fillim viti dhe vjen si kërkesa nga departamentet. Vendet vakante shpallen në faqen e Universitetit.</p> <p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek gjithë procedurat për plotësimin e vendeve vakante në strukturë me rekrutimet. Procedura e verifikuar nga dokumentacionet mbështetëse dhe nga vizita në institucion përfshin disa hapa të rëndësishme që nga shpallja e pozicionit të lirë në Web dhe rrjetet sociale të Universitetit, përshkrimin e pozicionit, kriteret e përgjithshme të pranimit, dokumentat për aplikim, ngritja e komisionit të posacëm, intervista përpara komisionit dhe vlerësimi i kandidatit dhe vendimi për aplikantin fitues.</p> <p>Procedurat, afatet e dorëzimit të dokumentacionit, procedura e konkurrimit, rezultatet, afatet e ankimimit janë objekt i rregullores së Universitetit si edhe Manualit të menaxhimit të burimeve njerëzore, sic u përmend edhe më lart.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 7 Manual i Menaxhimit të BNJ.pdf, vizita në institucion, në Zyrën e burimeve Njerëzore, Evidenca 36 të dhëna nga faqja zyrtare Web e UniBA, shpallja e vendeve të lira.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në rregulloren e UniBa, neni 48, përcakton përbërjen dhe kategoritë e personelit, ku përfshihet personelin ndihmës akademik, punësimi i të cilit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Neni 53 përcakton specifikisht rolin dhe detyrat e të drejtat e personelit ndihmës akademik. Personeli ndihmës akademik i angazhuar në DESF dhe përkatësisht në këtë program studimi është i angazhuar për mbështetjen e stafit akademik në funksion të programit të studimit, si dhe në orët e laboratoreve dhe në procesin mësimor.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.2 Rregullore e UniBa, RVB Menaxhim Biznesi.pdf]</i></p>

<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Dokumentacioni lidhur me personelin e institucionit, përfshirë personelin akademik dhe atë administrativ e ndihmës akademik, menaxhohet nga drejtoria e menaxhimit të Burimeve njerëzore. Ajo menaxhon dosjet personale të të gjithë punonjësve, duke përfshirë ata me kontratë të përhershme efektive dhe ata me kontratë të përkohshme të personel të jashtëm. Dosja përmban dokumentacionin personal të çdo punonjësi, librezën e punës dhe ndryshimet në dosje për shkak të zhvillimit të karrierës dëshmitë e kualifikimeve të mëtejshme të stafit. Nga vizita në zyrën e burimeve njerëzore, u evidentuan mbajtja e të dhënave dhe dosjeve me të gjithë elementët, duke bërë një përzgjedhje me dy anëtarë të stafit dhe u pa saktësia e mbajtjes së informacionit për stafin. Gjithashtu aty ruhet dhe u evidentua nga vizita edhe dokumentacioni i përgjegjës të departamentit, përgjegjës për organizimin e programit të studimit si edhe personave koordinatorë. Drejtoria e burimeve njerëzore është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të përditësuar për secilin anëtar të stafit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 7 Manual i Menaxhimit të BNJ.pdf, vizita në institucion, në Zyrën e burimeve Njerëzore]</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli përgjegjës për praktikën profesionale, është personel i departamentitn DESF, i cili garanton një proces të praktikave, të mbështetur nga marrëveshjet me organizata të biznesit, OJF, institucione shtetërore etj. Procesi ndiqet nga pedagogët e përcaktuar dhe procedurat janë të mirëpërcaktuara në paketën e miratura të praktikës. Realizohet një komunikim i vazhdueshëm midis pedagogut përgjegjës, studentit dhe mbikëqyrësit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me e-mail në rastet kur vendi i praktikës ndodhet jashtë qytetit të Tiranës. Studentët pas periudhës së ndjekjes së praktikës, sjellin në institucion vërtetimin nga kompania/organizata dhe gjatë periudhës bëhen 4 takime me pedagogun udhëheqës të praktikës.</p> <p>UniBa ka një listë isitucionesh dhe kompanish me të cilat ka marrëveshje, duke garantuar realizimin e praktikës mësimore në mjediset e kompanive/organizatave përkatëse. Madje UniBa ka edhe mjedise të brendshme laboratorë dhe mjedise të tjera për zhvillim të aktiviteteve praktike. Për praktikën tek subjektet realizohet një marrëveshje e qartë me institucionet që i garanton studentit vendosjen në mjediset e kompanive/organizatave përgjatë gjithë periudhës së praktikës. Departamenti mban marrëdhënie edhe me zyrën Alumni dhe karrierës për identifikimin e kompanive që mund të jenë pjesë e listës për praktika mësimore. Është me rëndësi të theksohet se departamenti për përcaktimin e vendit të praktikës, ka një bashkëpunim fillestar midis pedagogut udhëheqës dhe studentit.</p> <p>Në përfundim të studimeve realizohet punimi i diplomës, ku vendoset në dispozicion personeli akademik udhëheqës i diplomës, zakonisht brenda departamentit ose dhe nga jashtë departamentitn nëse vlerësohet e nevojshme, sigurisht me titujt dhe kualifikimet përkatëse. Gjithashtu për studentët që nuk përmbushin kriterin e mesatares, mbrojtja e diplomës bëhet me provim.</p>

	<i>[Referenca: Evidenca 2.3 UniBa paketa e praktikës, vizita në institucion, takimi me studentët, Evidenca 2.5 fondi i pyetje për provimin e formimit]</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, bën mbikqyrjen e studentit gjatë periudhës së praktikës së bashku me pedagogun e përcaktuar për udhëheqje dhe mbikqyrje. Gjithashtu mbikqyrësi në institucionin pritës merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. Kështu në përfundim të praktikës mësimore personeli mbikqyrës vlerëson punën e kryer nga studenti sipas një formati standart dhe e dorëzon atë pranë UniBa. <i>[Referenca: Evidenca 2.3 UniBa paketa e praktikës, vizita në institucion, takimi me studentët]</i>			
Konkluzione	<i>Përmbushja e standardit, është në nivelin plotësisht, duke qenë se programi i studimit realizohet nga një department me përvojë brenda fakultetit, si dhe ka pedagogë me titujt dhe gradat si dhe eksperiencën e duhur për të mbështetur proceset e mësimdhënies, kërkimit shkencor si edhe të gjitha procedurat e studentëve deri në diplomim si mbrojtjet e praktikave dhe diplomave. Rregulloret përkatëse janë të qarta dhe të mirëzbatuara lidhur me të gjitha pikat më sipër.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Ambjentet e Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë janë në dispozicion të të gjithë studentëve dhe pedagogëve e si rrjedhim edhe të studentëve të programit të studimit. Ambjentet fizike përfshijnë salla leksionesh seminaresh dhe laboratorë për zhvillimin e lëndëve aplikative. 3 Godinat kanë në dispozicion të FEQD, një numër prej 13 salla leksionesh, si edhe zyra, laboratorë informatike dhe mjedise të përbashkëta, restorant e nyje sanitare. Hapësirat infrastrukturorë janë të rëndësishme dhe UniBa është angazhuar në krijimin e një mjedisi mbështetës në të gjithë veprimtarinë e mësimdhënies. <i>[Referenca: Evidenca 31 Raport i ekspertit për infrastrukturën, Evidenca 31.1 TË dhëna për infrastrukturën dhe planimetria, vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve]</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik	Çdo sallë leksioni apo edhe seminari është pajisur me videoprojektor dhe gjithashtu me kompjuter desktop ose laptop. Në cdo sallë si edhe në mjedise të përbashkëta, vihet re suporti i teknologjisë, gjë që është edhe në prioritetet e institucionit, për tu realizuar në vijimësi dhe pak nga pak. Teknologjia nënkupton projektimin digjital si dhe

e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	përdorimin e mjeteve të tjera. Laboratorët janë të pajisur me një numër të konsiderueshëm kompjuterash duke patur parasysh grupet e studentëve. Pajisjet janë të reja në dhe situata është relativisht e kenaqshme për realizimin e orëve laboratorike. [Referenca: Evidenca 31 Raport i ekspertit për infrastrukturën, Evidenca 31.1 TË dhëna për infrastrukturën dhe planimetria, vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve]				
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Sipas vizitave në institucion dhe në strukturat e FEQD, u pa se laboratorët janë të përshtatur për realizimin e orëve të lëndëve bazë dhe lëndëve të lidhura drejtpërdrejt me diplomën e nivelit bachelor. Ka qenë mundësia për të kuptuar dhe. Krojuar Softwareve përkatës aplikativë për realizimin me rigorozitet të programit të këtyre lëndëve. [Referenca: Evidenca 31 Raport i ekspertit për infrastrukturën, Evidenca 31.1 TË dhëna për infrastrukturën dhe planimetria, vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve]				
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në UniBa, por në funksion edhe të këtij programi studimi janë një numër I konsiderueshëm laboratorësh, përkatësisht 10 dhe 11 në të dy godinat, ku studentët realizojnë orët e seminareve, si edhe labororet e lëndëve të caktuar ku studentët mësojnë programet aplikative në këto lëndë. Duke parë edhe mundësitë e punësimit në fushat ekonomike dhe financiare, sipas studimit të tregut dhe vizitës në institucion, këto janë laboratër shumë të rëndësishëm për aftësimin e studentëve. [Referenca: Evidenca 31 Raport i ekspertit për infrastrukturën, Evidenca 31.1 TË dhëna për infrastrukturën dhe planimetria, vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve]				
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standartit është e plotë duke qenë se mjediset mësimore dhe infrastruktura janë shumë të përshtatshme dhe të kompletuara për realizimin me sukses të programit të studimit dhe gjithashtu për të rritur kapacitetet e studentëve të lidhura me tregun e punës.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standartit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyset kryesit</th> <th>Përmbyset plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyset kryesit	Përmbyset plotësisht		X
Përmbyset kryesit	Përmbyset plotësisht				
	X				

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedis të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të	Biblioteka përmban literaturën e nevojshme të lidhur me programin e studimit. Gjithë literaturat në formën e librave dhe revistave në gjuhën shqipe dhe të huaj janë të kategorizuara sipas standarteve të bibliotekave, Ka një numër të konsiderueshëm titujsh në bibliotekën

<p>parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>e UniBa, ku ka po ashtu tituj të revistave, proceedings te konferencave kombëtare e ndërkombëtare, revista etj.</p> <p>Por patjetër që kërkohet një përditim me literaturat më të fundit, sidomos në shqip. Biblioteka garanton gjithashtu aksesin në disa databaza digjitale, ku në aspektin ekonomik mund të përmendim EconBiz, Open text book library, Open dissertations, Springerlink etj. Duke qene se ka bibliotekë dixhitale në dispozicion, kjo siguron më shumë cilësi në literaturën për programin e studimit.</p> <p>Gjithashtu biblioteka ka edhe katalogimin online në sistemin e bibliotekave, gjë që siguron përdoruesit të kenë informacion për gjithë titujt që janë në dispozicion si edhe të kërkojë tituj për të cilët ka interes.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 30.b kërkesë për tituj librash, Evidenca 30.c platforma e bibliotekës online, Evidenca 30.d Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës në funksion të prgramit të studimit, vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës.]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njëësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Drejtuesit e bibliotekës dhe punonjësit e saj raportojnë përditimin e titujve tek stafet akademike sipas departamenteve. Ndërsa njëësia përgjegjëse dhe stafi akademik i programit bën kërkesat zyrtare mbi përditimin e titujve dhe literaturave të nevojshme për programin e studimit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 30.b kërkesë për tituj librash]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën rrësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Burimet e bibliotekës janë kryesisht burime si për stafet akademike, edhe për studentët të cilët informohen dhe nxiten më shumë në përdorimin e këtyre burimeve, nëpërmjet komunikimit me pedagogët e secilës lëndë si edhe komunikimeve në mjediset e bibliotekës apo në mediat online të UniBa. Duhet thënë se studentët e UniBa dhe si rrjedhim të programit të studimit kanë mundësi të menjëhershme për përdorimin dhe aksesin e burimeve online duke qenë se kanë një llogari në system dhe adresa e-maili institucionale. Mundësia e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë tregohet edhe në të dhënat për infrastrukturën e bibliotekës, ku shpërndarja e titujve dhe organizimi i mjediseve, si edhe mundësia e përdorimit të kompjuterave desktop dhe laptop bëhen që të gjithë përdoruesve të bibliotekës tu jepen mundësi të barabarta. Gjithashtu edhe aksesin në bibliotekat online është për të gjithë përdoruesit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 30.d Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës në funksion të prgramit të studimit, vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës.]</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UniBa ka mbi në fondin e saj 4250 tituj ku përfshihen tekstat mësimore si dhe literature ndihmëse si dhe janë të kategorizuara në tituj shqip dhe të huaj. Gjithashtu ka tituj nga periodikë fizikë dhe të shkarkuar si Elsevier dhe tituj nga periodikët online. Mbulohen afërsisht të gjitha modulet mësimore të programit të studimit. Megjithatë ka ende hapësirë për përditimin e titujve sidomos në Shqip. Diskutimi me pedagogët e programit të studimit vuri në pah problemet e botimit të librave në shqip, në përgjithësi jo</p>

	<p>vetëm për këtë program studimit. Por të gjithë pedagogët kanë mbështetur me cikle leksionesh të rratuara.</p> <p>[Referenca: Evidenca 30.b kërkesë për tituj librash, Evidenca 30.c platforma e bibliotekës online, Evidenca 30.d Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës në funksion të prgramit të studimit, vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës.]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas informacionit mbi bibliotekën dhe rregulloreve të programit të studimit studentët mund të shfrytëzojnë bibliotekën në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë. Madje mjediset e saj janë të pajisura me kompjutera dhe internet, ku studentët mund të shfrytëzojnë pa kosto për projektet leximet gjatë orareve të studimit dhe leximit, e aksesit online nëpërmjet abonimeve të cilat janë të listuara tek Evidenca e informacionit mbi bibliotekën.</p> <p>[Referenca: Evidenca 30.d Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës në funksion të prgramit të studimit, vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës.]</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e UniBa menaxhon fondin përmes sistemit të platformës online, për menaxhimin e katalogut të bibliotekës sipas kategorive të ndryshme duke kontrolluar lehtësisht lëshimin/kthimin/vonesat/humbjet apo demtimet. Platforma online dhe gjithashtu jep mundësinë e aksesit në burimet e ndryshme elektronike ku institucioni është abonuar për akses online të librave dhe revistave shkencore apo arsimike, databazave online të artikujve. Secili përdorues ka llogarinë e tij që i mundëson hyrjen dhe aksesin në këto burime, duke bërë kusht që ato të shfrytëzohen pa kufizim për të gjithë, jo vetëm pedagogët, por edhe për studentët.</p> <p>[Referenca: Evidenca 30.d Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës në funksion të prgramit të studimit, vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës.]</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Stafi i bibliotekës menaxhon procesin e aksesit dhe menaxhimit të procesit të leximit dhe marrjes së librave, apo materialeve të tjera. Oraret e bibliotekës janë të përshtatshme për përdorimin dhe frekuentimin nga studentët, pasi është mundur që oraret e saj të përputhen me mundësitë për oraret e studentëve. Oraret janë 08:30 deri në 16:30 në dispozicion për marrjes dhe aksesit të materialeve, ndërsa pas orës 16:30 deri në orën 19:45, të mundshëm për akses janë vetëm ambjentet dhe mjediset për lexim, duke përfshirë sidomos dhe nevojën për materiale.</p> <p>[Referenca: Evidenca 30.d Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës në funksion të prgramit të studimit, vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës.]</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli</p>	<p>Raportimi për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe për përditësimin realizohen nga stafi i bibliotekës. Pedagogët e stafit të programit në analizën në departamente japin informacion lidhur edhe me gjendjen e literaturave dhe përditësimin e leksioneve dhe materialeve të cilat u shërbejnë studentëve por edhe fondit të bibliotekës.</p>

akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<i>[Referenca: Evidenca 30.b kërkesë për tituj librash, Evidenca 30.c platforma e bibliotekës online, Evidenca 30.d Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës në funksion të prgramit të studimit, vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës.]</i>		
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht pasi institucioni përmbush thujtë tërësisht kushtet për literaturën dhe shërbimet e bibliotekës duke garantuar paanshmëri, mundësi të barabara, orare shërbimesh të përshtatshme si edhe zhvillim dhe kualifikim të stafit, i cili bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Në UniBa ekziston sistemi i plotë i menaxhimit të informacionit, në formë Intranet, ku përfshihen me akses të gjitha zyrat mbështetëse administrate si edhe zyrat dhe organet mbështetëse të studeëntëve, dekanalti dhe stafet akademike. Sistemi i administrimit të të dhënave në përgjithësi zbaton me rigorozitet udhëzimet për hyrjen e një anëtari të stafit në intranet, si psh vendosja e komunimit duke dhënë të gjitha të dhënat personale të nevojshme. Gjithashtu UniBa ka ndërtuar disa manuale, ku përfshihet sa më lart, si udhëzuesi për portalin studentor. <i>[Referenca: Evidenca 37 Manuali i përdorimit të portalit studentor, Evidenca 38.d manual përdorimi Interanet.]</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i informacionit gjithashtu është planifikuar për menaxhimin e një pjesë të informacionit të stafit akademik, duke përfshirë orarin, lëndët nën përgjegjësi dhe kurset brenda një viti akademik. Gjithashtu nga pikëpamja e sistemit tradicional, të gjitha zyrat janë pjesë e sistemit të ruajtjes dhe shkëmbimit të informacionit kur është i domosdoshëm, ku përfshihet edhe pjesa e të dhënave të tjera, si dhe për personelin ndihmës akademik dhe administrativ apo partnerë të tjerë të angazhuar me programin.

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Pjesa e sistemit që mund të lidhet me bashkëveprimin interaktiv dhe format e shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve, është e pasqyruar tek pjesa e portalit e-student, Si dhe sistemi i ri sis Classter, ku hidhen të dhëna të notave dhe gjithashtu ka komponentet për akses tek të dhënat nga pedagogët, studentët dhe prindërit, si dhe bëhet menaxhimi i klasave, orareve, kurseve, aktiviteteve dhe shërbimeve të tjera, menaxhimi i strukturës së të dhënave dhe menaxhimi i kolegjeve. Nga ana tjetër për sa i përket shkëmbimit të informacioneve dhe dokumenteve të leksioneve, apo materialeve të mësimdhënies, përdoret paketa GSUITE, për të cilën gjithashtu ka një guidë në gjuhë të huaj kryesisht.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 37 Manuali i përdorimit të portalit studentor, Evidenca 38.d manual përdorimi Interanet, Evidenca 38 Manual i përdorimit të google classroom për pedagogët, Evidenca 38.a udhëzues për përdorimin e teknologjisë së Informacionit, Evidenca 38.b Manual i përdorimit të google classroom për studentët.]</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Format e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit midis personelit akademik dhe studentëve realizohen përmes google classroom, por nuk janë plotësisht të integruara platformat për menaxhimin e orareve, klasave dhe studentëve me platformat për shkëmbimin e informacioneve mbi mësimdhënien. Gjithsesi në UniBA vihet re një prirje drejt zhvillimit të mëtejshëm të risive teknologjike në funksion të mësimdhënies prandaj edhe zhvillimet e sistemit të brendshëm pritet të jenë shumë pozitive dhe në funksion të proceseve mësimdhënëse/mësimnxënëse.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 37 Manuali i përdorimit të portalit studentor, Evidenca 38.d manual përdorimi Interanet, Evidenca 38 Manual i përdorimit të google classroom për pedagogët, Evidenca 38.a udhëzues për përdorimin e teknologjisë së Informacionit, Evidenca 38.b Manual i përdorimit të google classroom për studentët. Vizita në institucion takimi me Dekanin dhe Shefin e Departamentit.]</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron monitorim në kohë reale të vlerësimeve dhe realizimit të aktivitetet akademik, por mund të përmirësohet duke shtuar module për rritjen e të dhënave të përpunueshme për të monitoruar më thellësisht aktivitetin akademik, shpërndarjen e materialeve dhe komunikimi pedagog student.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 38.a udhëzues për përdorimin e teknologjisë së Informacionit, Evidenca 38.b Manual i përdorimit të google classroom për studentët.]</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Duke studiuar Web-site të UniBa shohim se ky kriter përmbushet plotësisht pasi informacioni është i përdituar, dhe është i vendosur plotësisht në dy gjuhë.</p> <p><i>https://umb.edu.al/neës5284.html</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardit, është e plotë pasi u pa se UniBa ka një prirje shumë pozitive për të zhvilluar dhe përdorur</i></p>

	<p><i>teknologjinë dhe sistemet e ndryshme të vlefshme të informacionit, softwarët përkatës bazuar në Web për menaxhimin e informacionit kryesisht të brendshëm. UniBa ka zhvilluar manualette përkatëse për orientimin e përdoruesve në shërbimet që jep sistemi/sistemet aktuale të Teknologjisë së Informacionit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Ligji i arsimit të lartë 80/2015 krijon gjithë hapësirat ligjore për ndërtimin e mekanizmave të duhur për menaxhimin financiar të institucioneve të arsimit të lartë publikë dhe privatë në vend. Në bashkëveprim me menaxhimin e institucionit, si edhe në zbatim të gjithë udhëzimet përkatëse, është e mundur të kalohet deri në nivelin e programeve të studimit. Në relacionin për realizimin e buxhetit dhe planifikimin, mund të evidentohen elementet e realizimit financiar të buxhetit, por nuk ka evidencë për koston mesatare vetëm të studentëve të programit bachelor në Menaxhim Biznesi. Parashikimet për vitete e arshshme bëhen në projekt buxhetin afatmesëm. UniBa ka një raport financiar të qartë dhe të plotë mbi të ardhurat dhe kostot, duke u bazuar në ndarjen e tyre në disa zëra të ardhurash dhe shpenzimesh, në nivle institucional, por do të ishte me vlerë që zyra e financës të nxirrte një kosto totale për programin e studimit të marrë në shqyrtim dhe gjithashtu një kosto për student për programin bachelor në Menaxhim Biznesi. Nuk ka një ndarje reale të mjeteve financiare dhe parashikimit në nivel programi studimi.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 39 Të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional, Evidenca 40.a Burimet financiare të UniBa, Evidenca 40 të dhëna të planit të financimit të programit të studimit].</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të</p>	<p>Planifikimi financiar fillon që nga njësia bazë me kërkesat e paraqitura nga përgjegjësi i departamentit në dekanat dhe më pas në senatin akademik dhe bordin e administrimit. Dokumentacioni tregon për realizimin e një plani financimi në nivel institucional dhe jo në nivel programi studimi ku të evidentohen të gjitha kostot, psh kostot e personelit akademik, vetëm të këtij programi studimi. Në mbyllje të cdo cikli të plotë studimi institucioni dokumenton raportet financiare për tre vitet e fundit dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 39 Të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional, Evidenca 40.a Burimet financiare të UniBa, Evidenca 40 të dhëna të planit të financimit të programit të studimit].</i></p>


realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni përgatit raportet vjetore financiare dhe gjithë procedurat për miratim të vendimeve që lidhen me buxhetin dhe financat përcaktohen në statut dhe rregullore, të cilat zbatohen me rigorozitet. Sa i përket auditimit periodik, nuk ka një procedurë që evidenton këtë auditim si pjesë e auditit të brendshëm apo edhe të jashtëm. [Referenca: Evidenca 39 Të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional, Evidenca 40.a Burimet financiare të UniBa, Evidenca 40 të dhëna të planit të financimit të programit të studimit].		
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Raportimet janë në nivel institucional dhe ato të lidhura me realizimin e buxhetit nuk shkojnë deri në nivel programi studimi. [Referenca: Evidenca 39 Të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional, Evidenca 40.a Burimet financiare të UniBa, Evidenca 40 të dhëna të planit të financimit të programit të studimit].		
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Qëndrueshmëria financiare e institucionit garantohe për shkak të të ardhura nga burime të ndryshme të diversifikuara, ku UniBa ka mundur të mbledhë fonde nga tarifat e studentëve, ofrimi i shërbimeve mbështetëse, si konsulenca, trainime, të cilat kanë ardhur në rritje në tre vitet e fundit. Gjithashtu në rritje kanë qenë edhe të ardhurat nga studentët për shkak të rritjes së numrit të programeve të studimit dhe numrit të studentëve në disa prej tyre. [Referenca: Evidenca 39 Të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional, Evidenca 40.a Burimet financiare të UniBa, Evidenca 40 të dhëna të planit të financimit të programit të studimit].		
Konkluzione	<i>Shkallën e përmbushjes së standardit është kryesisht për shkak të mosrealizimit të buxhetimit, evedentimit të kostove dhe analizave financiare dhe auditimit në nivel programi studimi, gjë e cila kërkohet nga ky kriter. Në nivel institucional apo dhe fakulteti këto analiza dhe planifikime janë realizuar. Kjo në fakt është një prirje e përgjithshme që vihet re në shumë IAL si publike ashtu edhe private.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje paraqiten në statutin dhe rregulloret përkatëse të institucionit dhe Fakultetit. Bazuar në legjislacionin në fuqi institucioni vë në dispozicion të gjitha strukturat mbështetëse për të garantuar mbulimin e të gjitha aktiviteteve të studentëve nga hyrja në dalje.</p> <p>Struktura për shërbimet studentore përfshin nivelet që nga zv rektori për Cështjet e studentëve, zyra e rekrutimit pranimit dhe regjistrimit si edhe vetëorganizimet e studentëve, dekanin e studentëve dhe patjetër përfshijmë këtu edhe zyrën e Alumni dhe Karrierës. Të gjitha proceset gjatë programit të studimit, në diplomim dhe pas diplomimit mbështeten nga këto zyra në UniBa sipas rregullores së përgjithshme (neni 31-39) dhe statutit (kreu VI studentët).</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti].</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas Statutit dhe Rregullores UniBa, studimet në Bachelor në Menaxhim Biznesi, ashtu si në të gjitha degët mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarë etnikë dhe të huaj sipas kriterëve të përcaktuara. Strukturat e njësisë bazë, Zyrave mbështetëse të përmendura në kriterin 1, japin shërbimet dhe mbështetjen e tyre pa asnjë dallim dhe diskriminim për të gjithë studentët duke i trajtuar ata në kushte të barabarta.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti (Kreu VI), Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti (Kreu IX), Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit MB].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Pranimi në këtë program studimi bëhet sipas kërkesave ligjore në fuqi për çdo student që ka përfunduar maturën shtetërore. Në këtë program studimi nuk ka disa kriteret të vecanta për vetë natyrën e programit. Sipas vendimeve për kriteret, përvec rregullores së UniBA për pranimin e studentëve dhe funksionet e zyrës së pranimit dhe regjistrimit, zbatohen edhe vendimet e senatit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti (Kreu VI), Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti (Kreu IX), Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit MB, Evidenca 20.5 Vendim Senati për kriteret e pranimit të studentëve në të gjitha ciklet 2020-2021,].</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve janë transparente në Web-sitën e Universitetit, ku thuhet se: "Kriteri i pranimit për aplikim në të gjitha programet e ciklit të parë Bachelor në Universitetin "Barleti" është nota mesatare e studimeve të arsimit të lartë të mesëm, përcaktuar si nivel dhe mënyrë llogaritje</p>

<p>ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>sipas vendimit të Këshillit të Ministrave”. Gjithashtu gjenden aty edhe kriteret, procedurat dhe dokumentacioni i duhur për transferim dhe regjistrim në degët e dyta. Gjithashtu ka informacion të bollshëm për studentët të aksesueshëm nga publiku sa u përket sidomos studentëve, dhënies dhe vlerësimit të dijeve dhe diplomimit. <i>[Referenca: Evidenca 19 rregullore për transferimin dhe regjistrimin në programet e dyta, Web-site: https://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html, https://umb.edu.al/transferohu.html, https://umb.edu.al/procesi-akademik.html]</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Informacioni për aplikantët maturantë, lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit MB përgatitet nga njësia bazaë dhe miratohet nga senati akademik. Programet e studimit, kuotat së bashku me kriteret e pranimit publikohen dhe janë lehtësisht të aksesueshme në portalin U – Albania, ku insgtitucioni përditëson vazhdimisht kriteret në seksionin përkatës. Publikimi në Web-site të UniBa gjithashtu bëhet përpara se sa të follojë periudha e aplikimeve për në universitet. <i>[Referenca: Evidenca 20.5 Vendim Senati për kriteret e pranimit të studentëve në të gjitha ciklet 2020-2021, Web-site: https://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html]</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Si për gjithë programet, edhe për këtë program botohen kuotat për studentët, por nuk ka si në rregulloret apo edhe në vendimin e senatit, kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, pakicave, apo shtresave të marginalizuara. <i>[Referenca: Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti(Kreu IX), Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit MB, Evidenca 20.5 Vendim Senati për kriteret e pranimit të studentëve në të gjitha ciklet 2020-2021,].</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në rastet e kuotave për student të huaj, UniBa lejon ndjekjen e studimeve edhe nga këta studentë si dhe nga studentët nga trojet shqiptare, sipas të gjitha udhëzimeve të MAS. Insitucioni nuk vendos kritere të veçanta, përveç atyre të vendosura nga MAS, për ndjekjen e studimeve nga studentë të kësaj kategorie. <i>[Referenca: Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti(Kreu IX), Evidenca 20.5 Vendim Senati për kriteret e pranimit të studentëve në të gjitha ciklet 2020-2021,].</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Vendimet për mbështetjen e studentëve me bursë janë një nxitje që UniBa mund të bëjë për kategori studentësh të caktuar, bazuar në kriteret dhe aktet e brendshme normative. Këto bursa miratohen sipas procedurave në rregulloren e institucionit dhe nga Bordi I Administrimit, si edhe bëhen publike në Web-sitin zyrtar. <i>[Referenca: Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Neni 84]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht duke qenë se institucioni përmbush gjithë kornizën ligjore në fuqi, si dhe ka ndërtuar rregullore dhe procedura për të zbatuar këtë kornizë, lidhur me pranimin e studentëve, mbështetjen e tyre në procesin e shkollimit, mundësitë që u jep lidhur me mbështetjen financiare etj.</i></p>




	<i>Sygjerimi i vetëm këtu do të jetë parashikimi i rasteve edhe për pranimin e studentëve nga grupe të vecanta shoqërore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Në statutin e UniBa, në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e FEQS, paraqiten të gjitha procedurat se si studentët përparojnë gjatë programit, në lidhje me kurset, kreditet, kalimin nga një vit në tjetrin, diplomimin.</p> <p>Kohëzgjatja e studimeve, kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe ecuria e studimeve janë elemente të parashikuara në rregulloret e FEQS dhe rregulloren e studimeve bachelor në MB. Rregulloret nuk janë të botuara në Web-site, por studentët bëhen me dije në cdo vit akademik. Procedurat e përparimit akademik lidhen me procesin e mësimdhënies. Një pjesë e këtij informacioni është transparent në Web-site në seksionin e procesit akademik, si edhe përgjatë semestrave dhe vitit akademik. Çdo pedagog vendos në dispozicion syllabusin, me informacion mbi kreditet, synimet, temat, mënyrën e vlerësimit dhe këto shërbejnë për informimin e studentit se si do të mund të përparojë gjatë studimeve në çdo modul.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit MB, https://umb.edu.al/procesi-akademik.html, Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit të studimit]</i></p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Rregulloret gjithashtu përmbajnë nenet përkatëse për të informuar studentët në rastet e transferimeve për procedurat e njohjes së provimeve të mëparshme bazuar mbi programet si edhe njohjen e lëndëve dhe provimeve nga komisionet ad-hoc të ngritura për këtë qëllim.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 1, rregullore e fakultetit, Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit MB]</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Takimet informuese me studentët e kursit të parë nga përgjegjësi i departamentit dhe stafi akademik përbëjnë edhe një element shtesë për informimin mbi modulet, procedurat dhe mënyrat e përparimit të studentëve përgjatë gjithë periudhës së studimeve.</p> <p>Zyra e rekrutimit pranimit dhe regjistrimit, sekretariatë mësimore dhe stafet mbështetëse të departamenteve janë në dispozicion të studentëve të interesuar për të marrë më tepër informacion për çdo çështje me interes përgjatë periudhës së studimeve.</p>

	[Referenca: Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 1, rregullore e fakultetit, Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit MB]		
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit të studentëve janë të mirëpërcaktuara në rregulloret përkatëse dhe të shpallura në faqen e Internetit.</p> <p>Informimi i studentëve gjithashtu ndodh në takimet e sipërpërmendura informuese në cdo fillim viti akademik, si dhe nëpërmjet komunikimit me zyrat mbështetëse për studentët apo edhe në organet e ngritura nga vetë studentët për komunikimin institucional.</p> <p>[Referenca: Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 1, rregullore e fakultetit, Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit MB, Vizita në institucion takimi me studentët.]</p>		
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Fushata të informimit të studentëve si edhe faqja e Internetit janë dy mjete kryesore për udhëzimin dhe informimin e të interesuarve për të studiuar pranë UniBa si dhe në programin e studimit bachelor në MB. Një mënyrë e ndeshur gjithashtu është komunikimi midis të interesuarve, ku vihet re një këshillim pozitiv nga komuniteti i studentëve për ndjekjen e studimeve. Janë realizuar takime të hapura nëpër shkollat e mesme për informimin e të interesuarve.</p> <p>[Referenca: Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 1, rregullore e fakultetit, Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit MB, Vizita në institucion takimi me studentët.]</p>		
Konkluzione	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht për shkak se informimi i studentëve mbi rrugën e tyre të përparimit akademik realizohet nga institucioni dhe mjetet e informimit sidomos Website por edhe mjetet e komunikimit fizik të drejtpërdrejtë, po përdoren në mënyrën e duhur.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit është e parashikuar në rregulloren e FEQS dhe rregulloren e programin e studimit bachelor në MB. Përveç informimit përmes publikimeve në faqen e Internetit, në faqen e departamentit në Web-sitin e UniBa. Gjithashtu informacion jepet nëpërmjet takimeve në fillim të vitit akademik, takimeve me maturanët në ditët e informimit si dhe takimeve dhe komunikimeve me koordinatorin e programit, gjatë viteve të studimit dhe kur studentët e kërkojnë apo e kanë të nevojshme.

	<p>[Referenca: Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit MB, Vizita në institucion takimi me studentët, https://umb.edu.al/program-studimi/bachelor/bsc-menaxhim-biznesi.html]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit jep informacionin e nevojshëm për lëndët, modulet e programit të studimit. Mënyra se si institucioni informon studentët mbi programet e studimit dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese është përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Botimit të kurrikulës së detajuar me informacion për lëndët/modulet, kreditet, përmbajtjen dhe kategorizimin e veprimtarive nëpërmjet broshurës së botuar në faqen e programit në Web-site. • Botimit të Broshurës së përgjithshme ku gjendet informacion gjithashtu për programet • Prezantimit me informacionin që në fillim të regjistrimit të studentëve në UniBa dhe në takimet e para informuese • Nëpërmjet prezantimit të syllabuseve të cdo lënde në fillim të cdo semestri, sipas rregulloreve <p>[Referenca: Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit MB, Vizita në institucion takimi me studentët, https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/VOLANT-bsc-menaxhim-biznesi-upt-21.pdf, Evidenca 2.6 programet lëndore, syllabuset]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Elementi primar që i shërben institucionit dhe specifikisht departamentit për të promovuar studentët në tregun e punës është praktika profesionale. UniBa ka një sërë marrëveshjesh me kompani/organizata/administrate, ku në këtë diplomë mbështen studentët në procesin e praktikës duke sygjëruar dhe garantuar marrëveshje fillestare në tregun e punës.</p> <p>Nëpërmjet koordinimit me zyrën e këshillimit të karrierës dhe alumni si dhe me bordet e karrierës, Institucioni mundëson mbështetje për orientim në tregun e punës, si dhe në disa aspekte të këshillimit për ndërtimin e CV, aplikimit për punë, letrës së motivimit, kërkimit të informacionit për punë, etj.</p> <p>[Referenca: Evidenca 22 Tabelë përmbledhëse për institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe praktikën profesionale, Evidenca 22.1 Tabelë përmbledhëse për trainimet profesionale , Evidenca 22.2 Raport vjetor Alumni. Evidenca 28 Vendim për krijimin e Bordit të Karrierës]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacioni i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, gjendet në portalin studentor si dhe komunikohet fizikisht nga bashkëveprimi midis Dekanit të Studentëve, koordinatorit të departamentit dhe sekretarisë mësimore.</p> <p>Informacioni mbi orarin dhe sallat është i afishuar dhe orientimet fizike janë të mirëorganizuara.</p>

	<i>[Referenca: Evidenca 37 Manuali i përdorimit të portalit studentor, Evidenca 38.a udhëzues për përdorimin e teknologjisë së Informacionit, Evidenca 29. Guidë instruktive për mësimdhënien online, Evidenca 29.a Manual i mësimdhënies online, vizita në institucion takimi me Dekanin dhe Shefin e Departamentit.]</i>		
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit menaxhon pjesën e vlerësimeve, e si rrjedhim edhe me kurset që ndjekin studentët gjatë semestrit dhe është lehtësisht i arritshëm. Ndërkohe informacioni ndodhet edhe në faqen e Internetit, mbi lëndët dhe modulet duke qenë lehtësisht i arritshëm për studentët. Manuali i përdorimit të teknologjisë së informacionit udhëzon dhe lehtëson përdorimin e tij duke mundësuar aksesin e informacionit në distancë. <i>[Referenca: Evidenca 37 Manuali i përdorimit të portalit studentor, Evidenca 38.a udhëzues për përdorimin e teknologjisë së Informacionit, Evidenca 29. Guidë instruktive për mësimdhënien online, Evidenca 29.a Manual i mësimdhënies online, vizita në institucion takimi me Dekanin dhe Shefin e Departamentit.]</i>		
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit, është plotësisht duke qenë se institucioni realizon informacion të plotë studentëve për programin, modulet, procesin e edukimit dhe diplomimin.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UniBa përmes Sekretarisë Mësimore dhe zyrës së Alumni dhe Karrierës, grumbullon dhe përpunon të dhënat lidhur me regjistrimet/aplikimet duke përpunuar të dhënat lidhur me numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar, si dhe gjurmimin e studentëve, për programin e studimit bachelor në MB. <i>[Referenca: Evidenca 26.2 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve sipas viteve akademike].</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni përmes zyrës së Sekretarisë Mësimore gjithashtu mban informacion për të gjithë studentët që janë larguar nga programi përpara përfundimit apo për mospërfundimin me sukses të programit. Evidentimi për këtë fakt u bë në regjistrat, duke marrë një kampionim për programin e studimit dhe për të parë standartet e ruajtjes së informacionit. Gjithashtu evidencat tregojnë edhe dokumentat e mëposhtëm. <i>[Referenca: Vizita në institucion në Sekretarinë Mësimore, kontrolli I regjistrave]</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen	Të dhënat statistikore menaxhohen përmes sistemit tradicional të shpjeguar më lart dhe sistemit elektronik të Menaxhimit të

<p>përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Informacionit, i cili ruan të dhëna mbi notat, duke u ruajtur më pas dhe në regjistra së bashku me vlerësimet dhe arritjet akademike. Të dhënat e studentëve ruhen në sistemin e menaxhimit të informacionit përmes skedave të tyre Log-in, në mënyrë që ata të garantojnë marrjen e rezultateve përmes sistemit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 19.1 Rregullore e Sekretarisë mësimore, Evidenca 37 manual i përdorimit të portalit studentor, Evidenca 38.a Udhëzues për përdorimin e strukturës së Teknologjisë së Informacionit , Vizita në institucion në Sekretarinë Mësimore]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Zyra e Sekretarisë Mësimore është gjithashtu përgjegjëse për menaxhimin e dokumentacionit në mënyrë që të ketë mundësi të vlerësojë gjendjen aktuale dhe saktësinë e informacionit të studentëve dhe vlerësimeve të tyre të arritjeve akademike. Çdo student ka dosjen e tij me të dhënat që nga fillimi I marrëdhënies me institucionin, regjistrimit dhe në vijimësi arritjet akademike për cdo vit, e deri në përfundim.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 19.1 Rregullore e Sekretarisë mësimore, Evidenca 37 manual i përdorimit të portalit studentor, Evidenca 20, rregullore e zyrave studentore].</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>DESF harton raporte analitike të përvitshme të punës së departamentit, por në raportet e analizës nuk shihen të përfshira të dhënat lidhur me profilin dhe cilësinë e studentëve apo ndonjë informacion më I thelluar etj., duke bërë dhe analizat përkatëse dhe sygjëruar veprime për të ardhmen bazuar mbi këto statistika. Ka një plan pune që parashikon departamenti, gjithsesi ky plan duhet të përfshijë edhe procedurat për aksesin dhe analizën e të dhënave të studentëve dhe shfrytëzimin për vendimmarrje të nevojshme.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 19.1 Rregullore e Sekretarisë mësimore, Evidenca 37 manual i përdorimit të portalit studentor].</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardit është pjesërisht duke qenë se të dhënat dhe statistikat vjetore të studentëve ruhen në mënyrën e duhur, por përpunimet janë minimale dhe mund të përpunohen më thellësisht nga Departamenti në analizat e punës së tij vjetore. Kujdes duhet që këto përpunime dhe analiza që tashmë bëhen, të vihen në përdorim sa më efektiv për vendimmarrje lidhur me programin e studimit bachelor në MB.</i></p> <p><i>[Referenca: Evidenca 19.1 Rregullore e Sekretarisë mësimore, Evidenca 37 manual i përdorimit të portalit studentor].</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbyhet pjesërisht</p>	<p>Përmbyhet kryesisht</p>	<p>Përmbyhet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Studentët janë pjesë e strukturave drejtuese sipas ligjit 80/2015. Në UniBa studentët përfaqësohen edhe në përbërje të Senatit Akademik, Këshillin e Etikës dhe Shanseve të Barabarta, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standarteve të Cilësisë. Studentët organizohen gjithashtu në këshillin studentor/qeverinë studentore. Këshillat e studentëve janë organizata të pavarura të cilat nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike apo politike, por sigurojnë pjesëmarrjen e studentëve në procesin zgjedhor dhe koordinojnë pjesëmarrjen me përfaqësim në organet drejtuese, sipas ligjit për arsimin e lartë 80/2015. Studentët përfshihen gjithashtu edhe në veprimtari të tjera lidhur me institucionin, në rast se kanë dëshirë, psh në mbledhjet e hapura që organizon departamenti sipas rregullores së UniBa.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 20, rregullore e zyrave studentore, Evidenca 20.1 Rregullore e qeverisë studentore, Sekretarisë mësimore, Evidenca 37 manual i përdorimit të portalit studentor].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>E drejta e studentëve për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur në mënyrë që të përfaqësohen në organet drejtuese dhe komisionet e përhershme garantohet nga statuti i UniBa. Nga ana tjetër studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit të punës së programit dhe pedagogëve përkatës, kjo përmes formularit të anketimit të studentëve. Ky proces u jep atyre një fuqi reale për të ndikuar në proceset e mëtejshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 20, rregullore e zyrave studentore, Evidenca 12.a Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës Evidenca 16.4 formular i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët]</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Në UniBa për secilin prej programeve të studimit, si rrjedhim dhe për programin bachelor në MB, zhvillohen dy herë në vit, përpara sezonit të provimeve pyetësorët me studentët të cilët janë burimi më i rëndësishëm zyrtar që i përfshin studentët në dhënien e informacionit lidhur me lëndët dhe pedagogët, lidhur me vlerësimin për programin dhe sygjerimet përkatëse. Gjithashtu kjo bëhet edhe nëpërmjet fokus grupeve të studentëve të cilët japin feedback. Në mënyrë informale gjithashtu një informacion mbi mendimet e studentëve si dhe sygjerme lidhur me kurrikulën jepet në klasë në senacat e pyetjeve dhe diskutimeve sidomos në disa lëndë specifike të përshtatshme.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 12.a Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës Evidenca 16.4 formular i vlerësimit të]</i></p>

	<i>lëndës dhe pedagogut nga studentët, Evidenca 16.9 Guida për fokus grupin]</i>		
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmerinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Ka dy momente kryesore ku pasqyrohet marrja parasysh e mendimeve të studentëve për hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmes plotësimit të anketave, ku një informacion i kërkuar është përmes pyetjes së lidhur me procesin mësimor dhe programet apo informacionin në lidhje me lëndën. <p>Përmes komunikimit në klasë mbi kuptimin e lëndës, tematikës, bashkëveprim në seminare, shqyrtime rste studimit, apo pyetjeve nëse kërkojnë dicka të ndryshme apo tjetër lidhur me metodat dhe procesin e mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu ata kanë mundësinë të marrin pjesë edhe në disa mbledhje të hapura të departamentit si dhe të japin mendimet e tyre nëpërmjet përfaqësisë në organet drejtuese sipas statutit dhe rregullores.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 12.a Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës Evidenca 16.4 formular i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët]</i></p>		
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht duke qenë se institucioni përmbush kushtet dhe kriteret ligjore për përfshirjen e studentëve jo vetëm në organet vendimmarrëse, por edhe nëpërmjet rregulloreve dhe procedurave të zbatuara, edhe në përmirësimin e procesit të mësimdhënies.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmirësim	Përmirësim kryesisht	Përmirësim plotësisht
			X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Struktura drejtuese e UniBa e njësisë kryesore dhe e njësisë bazë DESF, janë në shërbim të vazhdueshëm të studentëve të kësaj dege. Dy fushat që bazohet shërbimi i studentëve janë: mesimdhënia dhe zhvillimi i karrierës.</p> <p>Ofrimi i shërbimeve dhe informacioneve është funksion dhe symin kryesor Në UniBa nëpërmjet zyrave mbështetëse për studentët, ku aktualisht përfshihen syra e Sekretarisë Mësimore, zyra e rekrutimit, pranimit dhe regjistrimit dhe Zyra e Alumni dhe Karrierës. Kanjë sërë mekanizmesh që përdoren për t'iu ofruar studentëve informacion mbi gjithë hallkat e procesit të arsimimit, informacion të dobishëm për mbarëvajtjen e procesit akademik të tyre si edhe informacion në raste transferimesh, midis IAL-ve. Dekani i studentëve është gjithashtu një nga këta mekanizma, sikundër edhe Zyra e rekrutimit, pranimit dhe</p>

	<p>regjistrimit, ku në funksionet e tyre është tremelior edhe informimi si shërbim për studentët.</p> <p>Një shërbim që u ofron informacion të rëndësishëm studentëve por sidomos në pjesën e fundit të studimeve të tyre, në qasjen me tregun e punës, por edhe lidhur me praktikën dhe kompanitë në treg, është AM Barleti Human Capital, si një qendër për lidhjen me tregun e punës.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 12.a Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sekretaria Mësimore dhe Zyra e rekrutimit, pranimit dhe regjistrimit ofron informacionin kryesor për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>Sa i përket aspekteve të lidhura strikt me procesin mësimor, studentët mund t'i drejtohen koordinatorit të departamentit dhe dekanit të studentëve, për zgjidhjen e problemeve, ose Zyrës së Alumni dhe Karrierës për çështje të përparimit të mëtejshëm akademik dhe drejt tregut të punës.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 20 Rregullore e zyrave studentore]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Alumni dhe Karrierës u shërben studentëve, për të mbështetur zhvillimin e karrierës së studentëve. Ajo në bashkëpunim me DESF ofron informacion mbi punësimin e mundshëm, praktikën, internshp në bazë të programeve përkatëse. Përmes Klubeve të studentëve, përmes një shumëllojshmërie aktivitetesh dhe përmes shërbimit të AM Barleti Human Capital, si një qendër për lidhjen me tregun e punës, institucioni ka krijuar shumë mundësi për punësimin në tregun e përshtatshëm të punës, përmes promovimit dhe marrëveshjeve me kompani dhe organizatat, si dhe me ruajtjen e marrëdhënieve me alumni.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 20 Rregullore e zyrave studentore, Evidenca 20.3 Manual i klubeve studentore]</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Njësia bazë është ajo e DESF dhe në bashkëpunim me Zyrën e Alumni dhe Karrierës dhe Zyrën e Rekrutimit pranimit dhe Regjistrimit, mbledh dhe përpunon të dhëna për studentët pas diplomimit. Zyra e Alumni dhe Karrierës është përgjegjëse për gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo përdor disa mjete për gjurmimin, si e-mail, telefon, media sociale duke mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me studentët.</p> <p>Gjithashtu ajo bën analiza vjetore lidhur me të dhënat e mbledhura dhe me gjurmimin dhe ua vë në dispozicion këto të dhëna organeve drejtuese.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 20 Rregullore e zyrave studentore, Evidenca 22.2 Raportim vjetor Alumni, Evidenca 22.3 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin, Tabela 23 Aneks]</i></p>

Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht pasi procedurat për orientimin e studentëve gjatë studimeve edhe pas përfundimit të tyre janë të mirëpërcaktuara nëpërmjet ngritjes së zyrave përkatëse si edhe të mirëzbatuara nga departamenti dhe për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X
---	------------------------------	-----------------------------	------------------------------	----------

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Duke u mbështetur në disa dokumente themelore sic janë Statuti i UniBa, Rregullorja e UniBa, si dhe disa rregullore të posaçme të lidhura me Procesin e cilësisë, mund të thuhet se inovacioni dhe metodat inovative janë themeli i zhvillimit të institucionit. Edhe në strategjinë e zhvillimit të programit të studimit, ka një sërë parimesh që vendosin mësimdhënie në një pozicion të favorshëm duke paraqitur nxitjen për përdorimin e metodave inovative.</p> <p>Sipas dokumenteve strategjike, UniBa e mbështet punën e vet në ndershmërinë, kreativitetin, lirinë akademike, bashkëpunimin dhe shkëmbimin për kërkimet në shkencë, dhe edukim.</p> <p>Udhëzuesi në nivel institucional për cilësinë dhe metodat inovative është pikërisht rregullorja e KSBC dhe udhëzuesi për metodat e mësimdhënies, si dhe formularët përkatës që udhëheqin procesin e udhëzimit për përdorimin e metodave inovative.</p> <p>[Referenca: Evidenca 11 Udhëzues për metodat e mësimdhënies, Evidenca 16 Manual i hartimit të kurrikulës, Evidenca 16.1 Udhëzues për shkrimin e RVB, Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 17.1 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë, Evidenca 29 guidë instruktive e mësimin online, Evidenca 29.a Manual i mësimin online, Evidenca 38 Udhëzues për provimet në google form]</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të	Struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në UniBa sipas edhe rregulloreve përkatëse është Njësia e zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NJZHKC). Ajo bashkërendon gjithashtu veprimet me Rektoren për çështjet akademike si dhe Zyrën e matjes së performacens për të ushtruar sa më mirë vepritanrinë në UniBa si dhe

<p>personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>për programin e studimit bachelor në MB. Mekanizmat e vendosur në rregulloret dhe udhëzuesin për cilësinë zbatohen për të vlerësuar periodikisht aftësitë mësimdhënëse innovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 11 Udhëzues për metodat e mësimdhënies, Evidenca 16.3 Raportim i punës semestrale të pedagogut, Evidenca 16.4 formular i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët, Evidenca 16.5 Formulari për transparencë i vlerësimit të stafit akademik, Evidenca 16. Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 17.1 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë,]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë me disa mënyra në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies e vlerësimit të dijeve. Vlerësimi i tyre është një nga komponentët e rëndësishëm të vlerësimit të mbarëvajtjes së lëndëve dhe stafit akademik. Përveç plotësimit të formularëve përkatës si format e vlerësimit të cilësisë, studentët kanë të drejtë të shprehen në të gjitha format për të vënë në dukje problemet lidhur me cilësinë, si në komunikimet me pedagogët, me dekanin e studentëve apo me zyra të tjera që kujdesen dhe mbështesin studentët në UniBa.</p> <p>Dy herë në vit realizohen pyetësorë, ku në to u kërkohet studentëve të shprehin mendimin dhe vlerësimin e tyre për pedagogët në mënyrën se si ata zhvillojnë lëndët që mbulojnë dhe se sa praktike apo i sukseshëm ka qënë metodologjia dhe praktika e realizuar nga ta. Monitorimi vlerësimi nga studentët bëhet menjëherë përpara fillimit të sezonit të provimeve duke mos e përfshirë këtë të fundit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 11 Udhëzues për metodat e mësimdhënies, Evidenca 16.3 Raportim i punës semestrale të pedagogut, Evidenca 16.4 formular i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët, Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 17.1 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë,]</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi NJZHKC. Njësia e sigurimit të cilësisë është ndër propozueset kryesore për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë. Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Këto struktura janë përgjegjëse jo vetëm për sigurimin dhe monitorimin e cilësisë, por edhe për garantimin e transparencës, duke i kaluar analizat e vlerësimit të performancës, të dhënat e pyetësorëve të realizuar etj., nëpërmjet hierarkisë deri në nivel departamenti. Sa i përket publikimit për studentët nuk vihen re publikime të përgjithshme analizash apo rezultatesh në faqen e Internetit që publiku të kuptojë më tepër mbi proceset dhe rezultatet më të thelluara të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p>



	[Referenca: Evidenca 11 Udhëzues për metodat e mësimdhënies, Evidenca 16.3 Raportim i punës semestrale të pedagogut, Evidenca 16.4 formular i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët, Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.3 Rregullore e Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë,]		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Si në udhëzuesin e sigurimit të cilësisë, ashtu edhe në dokumente të rregulloreve përkatëse, ka orientime për metodologjinë e vlerësimit të cilësisë dhe performancës në këtë drejtim, por jo se si mund të promovohen shembujt e praktikave më të mira. Nga ana tjetër nuk ka ndonjë evidencë që të tregojë për këtë. Analizat vjetore është më shumë një plan pune dhe realizimi i tij dhe nuk përmban paraqitje të praktikave më të mira në mësimdhënie. Gjatë vizitës në institucion gjithashtu nuk u specifikuan raste të tilla për programin e studimit. Por ka një sistem të mirëndërtuar për vlerësimin e performancës së stafit nga disa këndvështrime dhe drejtime, kështu që praktikatat më të mira, stafet me përvojë dhe performacë më të lartë, duhet të nxiten që të ndajnë përvojën e tyre. [Referenca: Evidenca 11 Udhëzues për metodat e mësimdhënies, Evidenca 16.3 Raportim i punës semestrale të pedagogut, Evidenca 16.7 raport mbi rezultatet e formularit të studentit, Evidenca 35 Analiza vjetore e departamentit të ekonomisë]		
Konkluzione	Shkalla e përmbushjes së këtij standardi është kryesisht. Megjithë ngritjen dhe funksionimin e strukturave përkatëse për sigurimin e cilësisë, duhet të bëhet më tepër përpjekje në të ardhmen sa i përket promovimit të praktikave më të mira të cilat vihen re lidhur me metodat e mësimdhënies apo rritjes dhe zhvillimit të stafit në karrierë, apo rezultateve në punën kërkimore shkencore. Gjithashtu këto fakte dhe rezultate duhet të jenë sa më transparente edhe për publikun pasi kjo do të rriste ndikimin në aplikimet dhe komunitetin e biznesit, grupeve të interesit dhe studentëve.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmb	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UniBa së pari, ka ndërtuar në strukturën organizative, organikën përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ashtu sikundër parashikon ligji I arsimit të lartë 80/15. Në këtë strukturë, përcaktohen përgjegjësitë për cilësinë sipas Statutit të UniBa dhe rregullores së institucionit. Së dyti, në planin strategjik UniBa ka disa orientime të forta për cilësinë dhe kjo mbështet një filozofi për rritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe përmirësimin në nivele institucional, që do të ndikojë edhe në nivel fakulteti dhe departamenti. Së treti, procedurat për sigurimin e

	<p>brendshëm të cilësisë janë ndërtuar dhe shprehur nëpërmjet rregulloreve përkatëse të strukturave përgjegjëse për cilësinë.</p> <p><i>[Referenca: : Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 10 Strategjia e zhvillimit Institucional, Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Duhet theksuar se procesi i vlerësimit i realizuar në kuadër të monitorimit të cilësisë rezulton si pjesë e strategjisë së institucionit për cilësinë dhe të qenit inovator. Kjo strategji bazohet gjithashtu në bashkëveprimin e një sërë hallkash brenda institucionit që janë përgjegjëse për cilësinë në tërësi, duke u nisur që nga burimet nejrëzore dhe matja e performancës, zyrat e studentëve dhe mbështetja e tyre, etj. Sa I përket bashkëpunimit me ekspertë të jashtëm, momentalisht mungon përfshirja formale e tyre qoftë në rregulloret përkatëse apo dhe në dokumnetacionshoqërues të angazhimeve të ndonje prej aktorëve të jashtëm, sic janë përfaqësuesit me të cilët institucioni ka marrëveshje apo përfaqësuesit në bordet e Alumni.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 10 Strategjia e zhvillimit institucional, Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 12.b Udhëzim i UniBa mbi mbledhjen e KVP, Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UniBa në dokumentet rregullatore përfshin edhe paketën e instrumenteve për matjen dhe vlerësimin e cilësisë. Në aspektin e sigurimit të Jashtëm të cilësisë ai i është nënshtruar vlerësimeve të jashtme, sic është edhe konkretisht ky proces. Pas vlerësimit të mëparshëm të këtij programi studimi institucioni ka ndërmarrë përmirësime dhe ka riaplikuar për akreditim të programit dhe kjo tregon për vijueshmërinë e procesit të përmirësimit të cilësisë, si kërkesë e rëndësishme institucionale.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 16.4 Formular i vlerësimit të lëndës dhepedagogut nga studentët, Evidenca 16.5 Formulari i vlerësimit të personleit për transparencë, Evidenca 16.6 Formulari për transparencë të vlerësimit,]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>Treguesit e qartë e të matshëm për të evidentuar cilësinë në mësimdhënie dhe kërkim, pasqyrohen në rregulloret, udhëzuesit dhe dokumenta të tjera institucionale. Konkretisht pedagogët bëjnë një raportim periodik për angazhimin në mësimdhënie, projekte, punë kërkimore dhe punë administrative. Veç vetëdeklarimeve, kontrolli i realizimeve brenda institucionit shërben për matjen e performancës së stafit dhe përfundimet apo dhe problematikat e shfaqura diskutohen në mbledhjet e departamentit, kjo sipas deklarimeve gjatë vizitës në institucion me përgjegjësin e departamentit dhe dekanin. Vihet re një mungesë në evidencën e analizës vjetore të departamentit në lidhje me analizimin e situatave të tilla nga pikëpamja dokumentare.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.3 formular raportim i punës semestrale, Evidenca 7 Manual i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Evidenca 35 Analiza vjetore e departamentit të ekonomisë]</i></p>

Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit është kryesisht pasi ka ende nevojë për përmirësimin e procedurave të përfshirjes së aktorëve të jashtëm dhe ekspertëve në vlerësim si edhe përdorimit të më shumë treguesve cilësorë në mënyrë formale, si psh përfshirja e feedback nga bordet Alumni apo diskutimet me aktorë të jashtëm, për të bërë promovime nxitëse të përmirësimit të cilësisë. Rekomandohet gjithashtu evidentimi në dokumentacionin e analizave vjetore të departamentit i rezultateve mbi matjen e performancës.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të</p>	<p>Vlerësimi i programit është proces që kryhet periodikisht, dhe është institucionalizuar përmes metodologjisë së përdorur. Informacionin që mblidhet nga burime të ndryshme, duke nisur me studentët, pedagogët apo mbledhjet formale, qe rezultojn si output i procesit dhe që prek dhe përfshin të gjitha hallkat e aktivitetit, institucioni e reflekton përmes procesit të përmirësimit periodik të programit, duke e kthyer këtë proces në një standart dhe instrument vlerësimi. Duke rishikuar programet e lëndëve, metodat dhe elemente të ndryshme të procesit të mësimdhënies, procesi i sigurimit të cilësisë rezultojn në një metodë nga poshtë-lart.</p> <p>Universiteti përcakton filozofinë, politikat dhe procedurat të cilat më pas aplikohen në rang departamenti. Sigurimi i brendshëm i cilësisë bëhet në tre mënyra kryesisht: a) nëpërmjet pyetësorëve të drejtuar studentëve (sqaruar në kriterin më sipër) të cilat plotësohen çdo semester; b) nëpërmjet asistimeve të pedagogëve të rinj nga pedagogë me eksperiencë dhe c) nëpërmjet vlerësimit të performancës së çdo pedagogu mbi baza viti akademik. Analiza e këtyre elementëve duhet të jetë si output i procesit deri në rang departamenti, por nuk kemi një dokument të plotë të analizës së departamentit (Evidenca 35 paraqet vetëm planin dhe jo një analizë të mirëfilltë). Ndërkohë analiza e pyetësorëve të studentëve është shumë e qartë dhe e detajuar, por nuk kemi të dhëna të ndara vetëm për këtë program studimi. Njohja e problematikave nga formularët e studentëve trajtohen në mbledhjet e departamentit.</p> <p>Sipas dokumentacionit dhe evidencave të paraqitura nuk kemi një analizë në rang departamenti për të evidentuar raportet e vlerësimit për këtë program studimi. Duke u bazuar në dokumentat dhe evidencat që na janë paraqitur mendojmë se analizat në nivel institucional bëhet bazuar mbi formularët e vlerësimit, ndërsa në nivel departamenti dhe programi studimi analiza për të evidentuar se si është përmirësuar cilësia si rrjedhim i përdorimit të të dhënave, është deri diku e munguar. Vetëm nga vizita në institucion e evidentuam disa forma të kësaj analize.</p>

mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	[Referenca: Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë, Evidenca 35 Analiza vjetore e departamentit të ekonomisë]		
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Në kuadër të vlerësimit të programit të studimit ka disa prej metodave të drejtpërdrejta që përdoren për të evidentuar mbarëvajtjen dhe problemet. Kështu mund të përmendim vlerësimin e kurrikulës pasi mund të evidentohet që kanë ndodhur ndryshime bazuar përmirësimet e vazhdueshme të syllabuseve të lëndëve apo metodave të përdorura, të evidentuara në analizat vjetore. SA u përket vlerësimeve të provimeve apo detyrave si dhe vëzhgime në auditor, edhe këto realizohen si pjesë e metodave të drejtpërdrejta dhe kjo doli nga takimi me pedagogët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu analizat bëhen edhe bazuar mbi rezultatet e provimeve të ndryshme si ai i diplomimit ku evidentohen notat mesatare. [Referenca: Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.4 Formulari i vlerësimit të lëndës dhepedagogut nga studentët, Evidenca 16.5 Formulari i vlerësimit të personelit për transparencë, Evidenca 16.6 Formulari për transparencë të vlerësimit.]		
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Përvec metodave të drejtpërdrejta, edhe metodat e tërthorta shërbejnë për vlerësimin e realizimit të mbarëvajtjes së cilësisë së këtij programi studimi. Sic u shpjegua edhe në kriteret më lart, sondazhet e studentëve bëhen 2 herë në vit duke dhenë rezultatet. Gjithashtu bëhen edhe sondazhe të Alumni për të evidentuar rezultatet në tregun e punës, ndërsa mungojnë sondazhe tek punëdhënësit apo institucionet bashkëpunuese për realizimin e programit të studimit. [Referenca: Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.3 formular raportim i punës semestrale, Evidenca 16.7 Raport mbi rezultatet e formularit të studentit 21-22 semestri i parë, Evidenca 16.8 Raport mbi rezultatet e formularit të studentit 21-22 semestri i dytë, Evidenca 35 Analiza vjetore e departamentit të ekonomisë]		
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së këtij standarti është kryesisht. Konkretisht mund të bëhen disa përmirësime të lidhura me kriterin 2, 3 dhe 4, duke formalizuar disa prej metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të cilat realizohen në mënyrë informale, sic janë sondazhet e bashkëpunëtorëve, punëdhënësve etj apo vlerësime të cilësisë së mësimdhënies në klasë gjatë orëve në auditor.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht
		X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

73

<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Udhëzuesi i sigurimit të cilësisë parashikon të gjitha politikat dhe procedurat e brendshme për sigurimin e cilësisë dhe paraqet gjithashtu aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të interesuar. Ai paraqet rolin e institucioneve drejtuese, si senati akademik, NJZHKC, departamenti dhe fakulteti, si orientuese dhe analizuese të të dhënave të cilësisë apo dhe vendimmarrëse në drejtim të përmirësimit të saj bazuar mbi të dhënat e mbledhura. Gjithashtu paraqet rolin e pedagogëve dhe studentëve si burim të dhënash për evidentimin e arritjeve dhe problemeve gjatë procesit të mësimdhënies. Roli I studentëve u tregua edhe më lart me përmirësimin e detyrimit për plotësimin e pyetësorëve për studentin, dy here në vit, si edhe një përfaqësues I studentëve është përfshirë në procesin e vlerësimit të brendshëm. Roli I pedagogëve është për vlerësimin e punës vetjake apo dhe të kolëgëve, në rang departamenti. Nuk ka formularë apo evidenca dokumentare për vlerësimin nga aktorë të jashtëm. Sic u përmend edhe në kriterin 4 më lart.</p> <p><i>[Referenca: : Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 11 Udhëzues për metodat ë mësimdhënies, Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Statuti i UniBa përcakton të gjitha strukturat, me përgjegjësitë dhe detyrat e tyre si për njësitë edhe për studentët, pedagogët dhe palët e interesuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Kështu thekson rolin e KSSC në nivel institucional dhe NJZHKC, duke përcaktuar detyrat e tyre gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë. Gjatë vizitës në institucion u vërejt se detyrat e këtyre njësive aktualisht po realizohen sic duhet për të përmirësuar procesin dhe zbatuar me rigorozitet rregulloret dhe statutin.</p> <p><i>[Referenca: : Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 11 Udhëzues për metodat ë mësimdhënies, Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë, Vizita në institucion me Njësinë e zhvillimit të kurrikulës dhe cilësisë]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e njësive bazë dhe kryesore janë themelore për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Nga sa u përmend edhe në standartin VI 3 si dhe në kriteret e mësipërme të këtij standarti, pedagogët e njësive bazë së pari bëjnë vetëvlerësimin nëpërmjet formularëve, por edhe japin vlerësimet e tyre në mbledhjet me synim analizën e mësimdhënies dhe të kërkimit. Procesi përfshin gjithashtu fakultetin sepse informacioni përcillet në nivel fakulteti për tu përpunuar më tej në analizat vjetore. Personeli ndihmës akademik dhe administrativ gjithashtu përfshihet me dhënien e mendimeve sipas problematikave nëse ka dhe sipas kompetencave. Studentët përfshihen përmes sondazheve me frekuencën e përcaktuar.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 11 Udhëzues për metodat ë mësimdhënies, Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë, Evidenca 16.3 formular</i></p>

	<i>raportim i punës semestrale , Evidenca 16.4 formular i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët]</i>		
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja e të gjithë aktorëve të brendshëm garanton dhe respekton integritetin akademik dhe shmangë diskriminimet apo pabarazitë. Kjo garantohej nëpërmjet Udhëzuesit të cilësisë si dhe formateve të miratuara të pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. Miratimi i tyre si edhe marrja përsipër e ruajtjes së konfidencialitetit dhe të dhënave personale garantohej si si nga departamenti, ashtu edhe nga institucioni në përgjithësi përmes rregulloreve përkatëse. [Referenca: Evidenca 11 Udhëzues për metodat e mësimdhënies, Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë]		
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Sa i përket ekspertëve të jashtëm, gjatë procesit të vlerësimit nuk ka të tillë, por janë konsideruar mendime nga profesionistë dhe kompanitë dhe organizatat me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, si burime të informacionit për vlerësimin e programit ose moduleve apo pjesëve të tij, kjo sidomos për modulën e praktikës mësimore. [Referenca: Evidenca 11 Udhëzues për metodat e mësimdhënies, Vizita në institucion me Njësinë e zhvillimit të kurrikulës dhe cilësisë].		
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit është kryesisht pasi e vetmja pikë ku duhet të përmirësohet procesi dhe sistemi i vlerësimit është përfshirja formale e aktorëve të jashtëm, të cilët përmenden në kriterin 1 dhe 5 të këtij standardi. Rekomandohet krijimi i një formulari vlerësimi edhe nga aktorët e jashtëm të cilët bashkëpunojnë për mbarëvajtjen e programit, ata që kanë marrëveshje për praktikën, ose dhe lektorët e ftuar apo përfaqësues të industrisë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	N	P	Kryesisht
			X

Standardi VI.5


Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UniBA vendos shumë informacion për publikun në Web-sitin zyrtar. Të gjitha veprimtaritë në kuadër të sigurimit të cilësisë, raportet politikat dhe strategjitë sipas deklaratave zyrtare vendosen në Web-site në seksionet dedikuar cilësisë. Publiku, studentët dhe gjithë të interesuarit aktualisht gjejnë informacion mbi cilësinë e studimeve në Universitetin BARleti, por disa prej dokumenteve duhet të vendosen. [Referenca: Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë] https://www.umb.edu.al

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Sistemi i sigurimit të brendshëm të Cilësisë ndërtohet mbi parimin e transparencës. Transparenca brenda institucionit garantohet nëpërmjet komunikimit të brendshëm dhe hierarkisë institucionale, detyrimeve të njëjësive përgjegjëse për cilësinë për të ndarë informacionin me stafin dhe studentët. Nga ana tjetër raportet që mendohet se janë relevante mund të vendosen edhe në Web-site në periudhat përkatëse të vlerësimit. Aktualisht në Web-site nuk gjendet ndonjë prej raporteve të vlerësimit, por mund të gjendet në intranetin e organizatës.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë]</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Planet e masave për përmirësimin e mangësive janë ndërtuar dhe realizuar në kuadër të analizave institucionale, mbledhjeve të departamentit apo në nivel fakulteti. Dokumentet e rregulloreve përkatëse përcaktojnë dhe procedurat se si do të ndërtohen dhe zbatohen planet e masave, apo kush I ka përgjegjësitë për to. Nga vizita në institucion u pa se ka një strukturë të përcaktuar për të arritur synimet e përmirësimit të procesit të cilësisë dhe zgjidhjes së problematikave të lidhura me këtë process.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UniBa vlerëson dhe favorizon përshkallëzimin e metodikës në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë kuadër përfshirja dhe aktivizimi i të gjithë aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është një nga objektivat kryesore të IAL në këtë drejtim.</p> <p>Universiteti është gjithashtu shumë transparent lidhur me çfarëdo informacioni, mase apo aktiviteti që duhet të ndërmeret lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Transparenca duket qartë në mbledhjet e departamentit të DESF. UniBa mendon se fryma e transparencës që ka arritur të aplikojë, është baza e shmangies të çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Evidenca 17 Rregullore e KSSC, Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Megjithëse mungojnë format e institucionalizuara, UniBa dhe departamenti konsultohen në mënyrë të vazhdueshme me aktorë të jashtëm dhe palë të treta, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Institucioni përmes pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura të asamblesë ndërgjegjëson studentët dhe personelin për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në universitet.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.1 Statuti i UniBa, Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti, Vizita në institucion, takimi me dekanin dhe NJZHKC]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht pasi transparenca dhe gjithëpërfshirja e aktorëve në zbatim garantohet</i></p>

	<i>nga strukturat e mirëpërcaktuara në detyrime dhe përgjegjësi apo dhe të drejta, si dhe nga eksperiencia institucionale në këto drejtime.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Institucioni ka një orientim të përgjithshëm për të patur programe bashkëkohore, në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe europiane e si rrjedhim edhe struktura dhe përmbajtja e programit të studimit të shqyrtuar përputhet plotësisht me drejtimit themelore akademike të institucionit, duke dhënë idenë e një kurrikule në qasje me kurrikulat në nivel ndërkombëtar.
2. Qasja institucionale ndaj të qenit novator në drejtim, në organizim dhe komunikim krijon një frymë bashkëpunuese dhe bashkëvepruese të përgjithshme dhe sidomos brenda fakultetit dhe departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave, e cila ndikon drejtpërdrejt jo vetëm në frymën pozitive të marrëdhënieve pedagog-student, pedagog-departament dhe brenda institucionit, por edhe në qasje novatore në elementet e programit të studimit, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit
3. Institucioni dhe në kuadrin e tij edhe FEQD dhe Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave, ka një përvojë disavjecare dhe bën vlerësimin e jashtëm në mënyrë periodike, duke përfshirë edhe programin e studimit bachelor në MB; duke dhënë kështu mundësinë për një shqyrtim dinamik dhe përditim të kurrikulës e cila aktualisht është e mirëndërtuar dhe ndërton njohuritë dhe kapacitetet e duhura për studentët.
4. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi dhe traditë në marrëdhënien me biznesin si dhe struktura të ngritura të alumni të cilt krijojnë mundësi punësimi për studentët që përfundojnë studimet bachelor në menaxhim biznesi.
5. Institucioni ka ndërtuar kurrikula në nivel Master që u japin mundësi studentëve të vazhdojnë studimet duke rritur nivelin e tyre të edukimit dhe formimit për tregun e punës.

Pika të dobëta

1. Vërehet se raporti PAE/PAK është rregulluar vetëm vitin e fundit akademik (2022-2023, 50 % PAE dhe 50 % PAK), pra nuk ka arritur ende një qëndrueshmëri të paktën afatmesme. **(Standardi II.2, Kriteri 1)**
2. Literatura në gjuhën shqipe është e vjetër, për shkak të mungesës së ribotimeve. **(Standardi IV.3, Kriteri 1)**
3. Programi i studimit nuk ka një koordinator të përzgjedhur specifikisht si përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. **(Standardi II.2, Kriteri 3)**
4. Disa prej metodave të kontrollit të cilësisë mbeten në nivele informale. Kështu mund të përmendim kontrollin përmes aktorëve të jashtëm, *sondazhet e bashkëpunëtorëve, punëdhënësve etj. apo vlerësime të cilësisë së mësimdhënies në klasë gjatë orëve në auditor.* Nuk ka analiza të informacioneve të mbledhura nga instrumentet dhe format e kontrollit të cilësisë në nivel departamenti apo programi studimi. **(Standardi VI.3, Kriteri 1 dhe 2)**
5. Mungojnë analizat financiare në nivel programi studimi. **(Standardi IV.5)**

Rekomandime

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

78

1. Institucioni dhe specifikisht departamenti duhet të mbajë të qëndrueshëm dhe mundësisht ta përmirësojë raportin PAE/PAK për të garantuar një qëndrueshmëri të programit nga stafi i brendshëm.
2. Literatura në gjuhën e programit, pra në Shqip duhet të jetë e përdituar, ose në rast të mungesave të kësaj literature për arsye objektive që nuk lidhen me institucionin apo pedagogët e lëndëve, duhet të vendosen në literaturën bazë ciklet e leksioneve të përdituara, të miratuara nga departamenti dhe të vlefshme në bibliotekë për studentët, me kopje të mjaftueshme.
3. GVJ sugjeron emërimin e koordinatorit të studimit sipas kërkesave të këtij vlerësimi duke patur parasysh jo thjesht detyra administrative të koordinatorit, por koordinimin akademik dhe mbështetjen specifike në lidhje me programin e studimit.
4. Vendosija në dispozicion e një personeli administrativ mbështetës në nivel departamenti, gjë që do të ndihmonte shumë në lehtësimin e punës administrative të stafit dhe do të mbështeste punën kërkimore.
5. Sygjerohet përfshirja e formularëve formal që duhet të plotësohen nga aktorë të jashtëm dhe ekspertë për programin e studimit, formalizimi i vlerësimeve në klasë si pjesë e rëndësishme e kontrollit të cilësisë dhe sidomos përfshirja në analizën e departamentit e të gjitha të dhënave të mbledhura nga strukturat e sigurimit të cilësisë, në nivel programi studimi.
6. Analiza e kostove duhet bërë deri në nivel programi studimi.



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Bachelor Program "Business Management" provided by the Higher Education Institution "Univeristy Barleti"

Strengths and affirmations


1. The institution has a general orientation and approach to contemporary programs, similar to international and European standards. Therefore, the structure and content of the examined study program is consistent with the main academic policies of the study, giving the idea of a curriculum with the international standards.
2. The institutional approach to innovation in leadership, administration and management and communication creates a general collaborative environment, especially within the faculty and the Department of Economics, Entrepreneurship and Finance, which directly affects not only the positive relationships lecturer-student, lecturer-department and within the institution, but also the innovative approach to study program elements, teaching and evaluation methods.
3. The institution, and in its framework the FEQD and the Department of Economy, Entrepreneurship and Finance, has several years of experience and performs external evaluation periodically, including the bachelor study program in BA, thus providing the opportunity for a dynamic review and update of the curriculum which is currently well-constructed and builds the right knowledge and capacities for students.
4. The institution has cooperation agreements and tradition in the relationship with business as well as established alumni structures that create employment opportunities for students who complete bachelor studies in business management.
5. The institution has built curricula at the Master's level that give the students the opportunity to continue their studies, increasing their level of education and training for the labor market.

Weaknesses

1. It is noted that the PAE/PAK ratio was adjusted only in the last academic year (2022-2023, 50% PAE and 50% PAK), so it has not yet reached at least medium-term stability. **(Standardi II.2, Kriteri 1)**
2. Literature in the Albanian language is old, due to the lack of reprints. **(Standardi IV.3, Kriteri 1)**
3. The study program does not have a coordinator, specifically entitled as responsible for the progress and development of the program and professional practices in accordance with its objectives. **(Standardi II.2, Kriteri 3)**
4. Some of the quality control methods remain at informal levels. Thus we can mention control through external actors, surveys of colleagues, employers, etc. or evaluations of the quality of teaching in the classroom during hours in the auditorium. There is no analysis of information collected by quality control instruments and forms at the departmental or study program level. **(Standardi VI.3, Kriteri 1 dhe 2)**
5. There is a lack of financial analysis at the study program level. **(Standardi IV.5)**

Recommendation

1. The institution and specifically the department must maintain and possibly improve the PAE/PAK ratio to guarantee a sustainability of the program from the internal staff.
2. The literature in the language of the program, i.e. in Albanian, must be updated, or in case of absence of this literature for objective reasons, not related to the institution or the lecturers of the subjects, updated lecture materials must be used as the basic literature, approved by the department and available in the library for students, with sufficient copies.
3. GVJ suggests the appointment of the coordinator of the study program according to the requirements of this evaluation, taking into account not just the administrative duties of the coordinator, but the academic coordination and specific support related to the study program.
4. The provision of administrative support staff at the departmental level, which would support in easing the administrative work of the staff and supporting research work.
5. It is suggested the inclusion of formal forms that must be completed by external actors and experts for the study program, the formalization of classroom assessments as an important part of quality control and especially the inclusion in the departmental analysis of all data collected by quality assurance structures, at study program level.
6. Cost analysis should be done up to the study program level.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

Phera

Balla